

# INDEKSI I TRANSPARENCËS PËR QEVERISJEN KOMUNALE 2020

## PËR 38 KOMUNAT E KOSOVËS

PRILL 2021



TRANSPARENCY AND  
ANTI-CORRUPTION





PRILL 2021

# **INDEKSI I TRANSPARENCËS PËR QEVERISJEN KOMUNALE 2020**

**PËR 38 KOMUNAT E KOSOVËS**



TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA © 2021. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit ose bartjes në asnjë formë mekanike ose elektronike, duke përfshirë fotokopjimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose tërheqjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura.

Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rruga Bajram Kelmendi, Nr. 45,  
10000, Prishtinë, Kosovë  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)  
Web: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Nga: Diana Metushi Krasniqi

Dizajni: Envinion

Ky publikim është përgatitur nga Instituti Demokratik i Kosovës - Transparency International Kosova dhe përkrahur nga USAID përmes aktivitetit të Komunave Transparente, Efektive dhe Llogaridhënese (USAID TEAM). Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

# PËRMBAJTJA

<b>LISTA E SHKURTESAVE .....</b>	<b>8</b>
<b>HYRJE .....</b>	<b>9</b>
<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>10</b>
<b>RENDITJA E KOMUNAVE.....</b>	<b>14</b>
<b>METODOLOGJIA E HULUMTIMIT .....</b>	<b>16</b>
<b>LISTA E TREGUESVE.....</b>	<b>20</b>
<b>ANALIZA KRAHASIMORE 2015-2020 .....</b>	<b>25</b>
<b>ANALIZA KRAHASIMORE 2018-2020 .....</b>	<b>30</b>
<b>SHTYLLA I: TRANSPARENCA NË PROKURIMIN PUBLIK.....</b>	<b>32</b>
Planifikimi i prokurimit në faqen e internetit .....	34
Transparenca në aktivitetet tenderuese .....	35
Njoftimet për kontratë.....	35
Njoftimet për dhënie të kontratës.....	36
Publikimi i kontratave të nënshkruara dhe vendimeve të OSHP-së .....	39
Transparenca në ankandet publike.....	41
Informacione mbi ankesat e shkallës së parë në lidhje me procesin e prokurimit publik.....	43
<b>SHTYLLA II: TRANSPARENCA BUXHETORE.....</b>	<b>45</b>
Publikimi i planit të investimeve në faqen e internetit .....	48
Publikimi i buxhetit të miratuar në faqen e internetit.....	49
Publikimi i ndryshimeve në ndarjet buxhetore në faqen e internetit.....	50
Publikimi i raporteve financiare tremujore në faqet e internetit.....	50

Publikimi i raportit vjetor përmbledhës për buxhetin e komunës për vitin paraprak fiskal në faqen e internetit .....	51
Publikimi i kornizës afatmesme buxhetore në faqen e internetit .....	52
Raporti i auditimit në faqen e internetit .....	52
Publikimi i raportit vjetor për subvencionet në faqen e internetit .....	53
<b>SHTYLLA III: QASJA NE DOKUMENTE PUBLIKE .....</b>	<b>54</b>
<b>SHTYLLA IV: INFORMIMI DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT .....</b>	<b>55</b>
Qasshmëria dhe konsultimi publik .....	57
Seancat e hapjes së tenderëve .....	57
Publikimi i projektbuxhetit për konsultime publike .....	57
Publikimi i draft vendimeve dhe/ose agjendave për konsultim me publikun .....	57
Dëgjimet publike .....	58
Vizitat e qytetarëve në faqet e internetit të komunës .....	59
Komunikimi me komunën .....	61
Informacion mbi ndërmarrjet komunale dhe institucionet vartëse .....	62
<b>SHTYLLA V: GRANTET DHE FINANCIMI .....</b>	<b>63</b>
<b>SHTYLLA VI: ETIKA PROFESIONALE DHE KONFLIKTI I INTERESIT .....</b>	<b>67</b>
<b>PËRFUNDIMET .....</b>	<b>72</b>
<b>REKOMANDIMET .....</b>	<b>73</b>



Në kohëra si këto, transparenca ka  
rëndësi më shumë se kurrë  
Nevoja për transparencë dhe  
llogaridhënie gjatë pandemisë COVID-19  
shkon përtej sistemeve shëndetësore.”

Transparency International, 2020

# LISTA E SHKURTESAVE

<b>E-PROKURIMI</b>	Platforma elektronike e prokurimit publik
<b>IPP</b>	Indeksi i prokurimit publik
<b>KDI</b>	Instituti Demokratik i Kosovës
<b>KRPP</b>	Public Procurement Regulatory Commission
<b>LPP</b>	Ligji për Prokurimin Publik
<b>MAP</b>	Ministria e Administratës Publike
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>MPL</b>	Ministria e Pushtetit Lokal
<b>MPMS</b>	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
<b>NVM</b>	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
<b>OSHP</b>	Organi Shqyrtues i Prokurimit
<b>TI</b>	Transparency International
<b>TIK</b>	Transparency International Kosovë
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ
<b>ZKA</b>	Zyra Kombëtare e Auditimit





# HYRJE

Viti 2020 nuk ishte një vit i zakonshëm për asnjë qeveri, proces apo qytetar. Ashtu si i gjithë globi, Kosova u përball me pandeminë COVID-19 dhe efektet anësore të saj. Kërcënimi i shëndetit publik kishte shtyrë qeverinë dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të merrnin vendime lidhur me kufizime të vëvizjes dhe të distancimit shoqëror. Këto kufizime ndikuan funksionimin e qeverisë qendrore dhe atyre lokale, si dhe jetën e mirëqenien e qytetarëve. Duke qenë përballë një rreziku të madh, qytetarët ishin, më shumë se çdo herë tjetër, të varur nga veprimet dhe informacionet qeveritare.

Kosova u përball me pandeminë pa përgatitje financiare, plan veprimi ose infrastrukturë të nevojshme, dhe të parët që u ballafaquan me këto sfida ishin komunat<sup>1</sup>. Kjo *forcë madhore* nxiti një rritje të përdorimit të shpenzimeve emergjente dhe të paplanifikuara për të akomoduar nevojat e shëndetit publik dhe mirëqenies sociale. Si rezultat, transparencja u anashkalua me procedura të përshpejtuar të prokurimit si në qeverisjen qendrore ashtu edhe në qeverisjen lokale, kështu, siç shpërfaqin disa studime<sup>2</sup>, duke rritur rrezikun e shpenzimit të parave publike me më pak kujdes.

Viti 2020, më shumë se kurrë, ngriti rëndësinë e transparencës. Ndërsa jeta, shëndeti, mirëqenia sociale, arsimit dhe ekonomia vareshin nga mbështetja e qeverisë, si dhe ballafaqimi i qeverisë me uljen e të ardhurave nga mbledhja e taksave, tatimeve dhe akci-

zave, kishte raportime të vazhdueshme të humbjes së parave publike përmes çmimeve të larta të blerjeve emergjente, favorizimi dhe mungesa e llogaridhënies, e cila mbetet një sfidë e vazhdueshme në qeverisjen publike në Kosovë<sup>3</sup>.

Për të pestin vit radhazi, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) / Transparency International Kosova (TIK), përmes publikimit të Indeksit të Transparencës, vazhdon të hedh dritë mbi shpenzimet komunale përmes prokurimit publik dhe financimit dhe duke inkurajuar institucionet që të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët. Qëllimi i këtij Indeksi është të informojë qytetarët për nivelin e transparencës dhe efikasitetit me të cilat qeveritë lokale ofrojnë mallra, punë dhe shërbime, dhe të inkurajojë institucionet për të kryer planifikim dhe shpenzime financiare më efikase dhe transparente.

1 Vendimi i Qeverisë së Kosovës Nr. 01/09 për karantinimin e komunave të Klinës dhe Vitisë, I datës 13 mars 2020

2 Kosova gjatë pandemicë COVID-19, Fondacioni Friedrich Naumann, maj 2020; I qasshëm në: <https://www.freiheit.org/western-balkans/kosovo-during-pandemic-covid-19>

3 Raporti i progresit për Kosovën, Komisioni Evropian, tetor 2020





# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në vitin 2020, duke u përballur me pandeminë COVID-19, Kosova pësoi një rënie të transparencës në qeverisjen lokale **me 1% krahasuar** me vitin paraprak (2019). Transparenca e përgjithshme në gjashtë shtylla në vitin 2020 është **69%** krahasuar me 70% në 2019. Ndonëse kjo nuk është një ngecje e madhe, ajo pati një ndikim në frenimin e trendit të vazhdueshëm pozitiv të dëshmuar në vitet e fundit. Një nga shkaqet kryesore në këtë rënie të transparencës ishte funksionimi i administratës publike me kapacitete të kufizuara për pjesën më të madhe të vitit për shkak të pandemisë.

Rezultatet e këtij indeksi bazohen në **gjashtë shtylla** që synojnë të matin se sa transparente janë komunat ndaj shpenzimeve publike përmes prokurimit publik dhe granteve dhe subvencioneve, sa është përfshirja e publikut në këto procese, sa të përgjegjshme janë komunat dhe nëse ato posedojnë mekanizmat e nevojshme të përgjegjësisë për të raportuar dhe luftuar korrupsionin dhe qëllimet e paligjshme. Këto gjashtë shtylla janë matur bazuar në **41 indikatorë**, 29 prej të cilëve janë tregues të produktit që matin nëse aktivitetet dhe veprimet e planifikuara janë duke u zbatuar siç janë parashikuar ose siç kërkohet nga ligji dhe 12 tregues të performancës që matin cilësinë e produktit/aktivitetit të komunës.

Indeksi për vitin 2020 tregoi se transparenca në shtyllën e **prokurimit publik** në qeverisjen lokale **ka mbetur e njëjtë me atë të një viti më parë, me 57%**. Indeksi ka zbuluar se ndërsa disa komuna të mëdha e kanë rritur transparencën e tyre në publikimin e dokumenteve të

tyre të prokurimit, ulja e transparencës në komunat më të vogla i atribuohet nivelit të transparencës që nuk tregojnë ndonjë përparim.

Viti 2020 tregoi **një ndryshim prej -12% në shtyllën e transparencës buxhetore**, nga 73% në 2019 në 61% në 2020. Kjo rënie i atribuohet: mungesës së publikimeve të buxhetit (vetëm 26 komuna në vitin 2020 publikuan buxhetin e tyre krahasuar me 31 komuna në vitin 2019); publikimin e ndryshimit të buxhetit (vetëm 3 komuna kishin publikuar ndryshimin e buxhetit, ndërsa 10 komuna nuk kishin asnjë ndryshim sipas ligjit për ndryshimin e ndarjeve buxhetore); plani i investimeve (vetëm 19 në 2020 krahasuar me 28 komuna në 2019); raportet tremujore të shpenzimeve (29 komuna, njësoj si një vit më parë); raportin përmbledhës për buxhetin e komunës për vitin e kaluar fiskal (30 në 2020 krahasuar me 31 komuna në 2019); korniza buxhetore afatmesme (28 në 2020 krahasuar me 29 komuna në 2019); dhe raportin e auditimit komunal (27 komuna e publikuan atë, njësoj si në vitin 2019).

Sidoqoftë, viti 2020 shënoi një trend pozitiv në qasjen në dokumentet publike. Indeksi tregon se nivelet e transparencës në këtë shtyllë **janë ndryshuar me +6%** (84% në 2020 krahasuar me 78% në 2019). Përderisa pandemia ndikoi në të gjitha instancat e veprimtarive qeveritare dhe jo-qeveritare, gjithashtu në vitin 2020, numri i kërkesave për qasje në dokumente publike ishte ulur. Në vitin 2020, kishte **një rënie** të kërkesave për dokumente publike nga 1,039 në 2019 në 843 kërkesa në 2020. Gjithashtu pati edhe një rënie të kërkesave që



kishin të bënin me dokumente në lidhje me prokurimin publik, përkatësisht **nga 417 në 2019 në 327 në 2020**. Sidoqoftë, kishte një rritje e numrit të komunave që iu përgjigjën kërkesës së KDI-së për informacion dhe bazuar në informacionin e marrë nga 32 komuna nuk kishte kërkesa të refuzuara ose të papërgjigjura për dokumente publike gjatë vitit 2020.

Një trend pozitiv ishte vërejtur edhe në shtyllën e informacionit dhe pjesëmarrjes së publikut. Monitorimi i KDI tregoi se **28 komuna** publikuan parashikimet e tyre të buxhetit dhe hapën këtë proces për konsultim publik. Ndërsa **31 komuna** publikuan projektvendimet e tyre për investimet komunale, përfshirë agjendat e tyre në faqet e tyre të internetit, dhe 35 komuna ofruan mjete të komunikimit elektronik përmes adresave të postës elektronike ose kutive të komunikimit në modulin e kontaktit. Nga ana tjetër, sipas të dhënave të marra nga **32 komuna** që iu përgjigjën kërkesës për informacion, gjatë vitit 2020, këto komuna organizuan **169 dëgjime buxhetore me 16,718 pjesëmarrës**. Një nga kontribuesit kryesorë në rritjen e pjesëmarrjes së publikut ishte përdorimi i rrjeteve sociale si mjete dixhitale të komunikimit me qytetarët.

Sidoqoftë, 2020 tregoi një **ndryshim prej -3%** të transparencës në komuna në promovimin e etikës profesio-

nale dhe luftimin e konfliktit të interesit nga 76% në 2019 në 73% në 2020.


Publikimi i këtyre dokumenteve në faqet e internetit të komunave është linja e parë e llogaridhënies ndaj qytetarëve të tyre. Për më tepër, kjo dëshmohet nga numri i vizitave në faqet e internetit të komunave. Sipas informacionit të marrë nga Ministria e Pushtetit Lokal (MVL), faqet e internetit të komunave në vitin 2020 u vizituan **4,167,112** herë, nga 1,248,850 vizitorë.

Ky është një tregues i qartë se përveç sfidave për t'u ballafaquar me një **forcë madhore**, komunat duhet të përqendrohen në publikimin e më shumë informatave për qytetarët e tyre. Përderisa të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me prokurimin publik dhe buxhetin duhet t'i raportohen qeverisë qendrore, komunat duhet të krijojnë struktura që të njëjtat të publikohen menjëherë edhe në faqet e tyre të internetit.



Gjithashtu, KDI inkurajon të gjitha komunat të rishikojnë mangësitë e tyre në këtë indeks për vitin 2020 dhe të përqendrohen në rritjen e transparencës në të gjitha shtyllat në 2021, pa marrë parasysh sfidat e implikuara nga pandemia.

Në vitin 2020, duke u përballur me pandeminë **COVID-19**, Kosova pësoi një rënie të transparencës në qeverisjen lokale me **1%** krahasuar me vitin paraprak (2019).

# MESATARJA E TRANSPARENCËS KOMUNALE NË GJASHTË SHTYLLA



# RENDITJA E KOMUNAVE



0 KOMUNA MË SË PAKU  
TRANSPARENTE

KOMUNA MË  
TRANSPARENTE 100



# RENDITJA E KOMUNAVE

Tabela e mëposhtme tregon pikët e fituara nga secila komunë, për secilën nga shtyllat e matura:

Komuna / shtylla		Shtylla I - Prokurimi publik (duke përfshirë ankandet publike)	Shtylla II - Trans- parenca buxhetore	Shtylla III - Qasja në dokumente publike	Shtylla IV - In- formimi dhe pjesëmarrja e publikut	Shtylla V - Grantet dhe financimi	Shtylla VI - Etika profesionale dhe konflikti i interesit	PIKËT E PËRC- JITHSHE PËR KOMUNË
Pikët maksimale		KOMUNË	25	10	15	10	10	100
1	Prishtinë	30.00	25.00	10.00	15.00	10.00	10.00	100.00
2	Lipjan	30.00	25.00	10.00	15.00	8.75	10.00	98.75
3	Gjakovë	27.00	25.00	10.00	15.00	7.50	10.00	94.50
4	Vushtrri	28.50	21.88	10.00	15.00	7.50	10.00	92.88
5	Rahovec	28.50	21.88	10.00	15.00	6.25	10.00	91.63
6	Junik	27.00	21.88	10.00	15.00	7.50	10.00	91.38
7	Glllogoc	23.85	21.88	10.00	15.00	7.50	10.00	88.23
8	Ferizaj	21.00	21.88	10.00	15.00	7.50	10.00	85.38
9	Shtime	24.00	18.75	10.00	15.00	6.25	10.00	84.00
10	Mamushë	28.50	12.50	10.00	15.00	7.50	8.75	82.25
11	Pejë	24.00	15.63	10.00	15.00	6.25	10.00	80.88
12	Hani i Elezit	16.35	21.88	10.00	15.00	7.50	10.00	80.73
13	Skenderaj	20.40	18.75	10.00	15.00	7.50	8.75	80.40
14	Podujevë	22.35	18.75	10.00	15.00	6.25	7.50	79.85
15	Prizren	20.25	18.75	10.00	15.00	7.50	7.50	79.00



|||||

Komuna / shtylla		Shtylla I - Prokurimi publik (duke përfshirë anandët publike)	Shtylla II - Trans- parenca buxhetore	Shtylla III - Qasja në dokumente publike	Shtylla IV - In- formimi dhe pjesëmarrja e publikut	Shtylla V - Grantet dhe financimi	Shtylla VI - Etika profesionale dhe konflikti i interesit	PIKËT E PËR- JITHSHME PËR KOMUNË
16	Suharekë	24.00	15.63	10.00	15.00	7.50	6.25	78.38
17	Istog	27.00	12.50	10.00	15.00	3.75	7.50	75.75
18	Kamenicë	20.85	15.63	10.00	15.00	7.50	6.25	75.23
19	Gjilan	22.50	12.50	10.00	15.00	7.50	7.50	75.00
20	Mitrovicë e Jugut	17.10	18.75	10.00	15.00	7.50	6.25	74.60
21	Deçan	21.45	20.31	10.00	9.00	5.00	8.75	74.51
22	Viti	14.25	15.63	10.00	15.00	6.25	8.75	69.88
23	Malishevë	6.00	21.88	10.00	15.00	7.50	8.75	69.13
24	Klinë	21.00	12.50	10.00	12.00	5.00	7.50	68.00
25	Kaçanik	13.50	12.50	10.00	15.00	7.50	8.75	67.25
26	Obiliq	12.00	15.63	10.00	15.00	7.50	6.25	66.38
27	Dragash	11.40	21.88	10.00	9.00	7.50	6.25	66.03
28	Graçanicë	13.50	15.63	0.00	12.00	6.25	6.25	53.63
29	Klllokot	15.00	18.75	0.00	7.50	6.25	3.75	51.25
30	Fushë Kosovë	3.00	15.63	10.00	10.50	3.75	6.25	49.13
31	Shtërpçë	4.65	9.38	10.00	9.00	1.25	5.00	39.28
32	Novobërdë	6.75	6.25	0.00	12.00	3.75	6.25	35.00
33	Ranillug	3.00	9.38	0.00	6.00	3.75	5.00	27.13
34	Zveçan	6.00	0.00	10.00	6.00	0.00	5.00	27.00
35	Partesh	3.00	0.00	0.00	15.00	5.00	3.75	26.75
36	Zubin Potok	3.00	0.00	10.00	3.00	0.00	3.75	19.75
37	Leposaviq	6.00	0.00	10.00	1.50	0.00	1.25	18.75
38	Mitrovicë e Veriut	3.00	0.00	0.00	1.50	0.00	1.25	5.75

0

KOMUNA MË SË PAKU  
TRANSPARENTËKOMUNA MË  
TRANSPARENTË

100

|||||

# METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), kapitulli i Transparency International (TI) për Kosovën, është mbështetur në metodologjinë standarde të Transparency International gjatë viteve të fundit për ta matur transparencën e institucioneve në prokurimin publik. Në vitin 2018, KDI e ka përmirësuar metodologjinë për të përfshirë dispozita të reja ligjore në prokurimin publik në Kosovë.

Kjo metodologji e përmirësuar e vlerësimit u miratua në Kosovë përmes një procesi pjesëmarrës që përfshinte ekspertë teknikë dhe palë nga qeveria lokale<sup>4</sup>. Ky proces pjesëmarrës ishte informativ për komunat dhe çoi në nivele më të larta të pronësisë së komunës për procesin e vlerësimit. Rekomandimi i grupit të fokusit ishte të grupohen treguesit e të njëjtës natyrë në shtylla, duke kombinuar kështu prokurimin publik dhe ankandet në një shtyllë të vetme, siç përcaktohet më poshtë. Me rekomandimin e grupit të fokusit u shtuan dy shtylla të reja për t'i trajtuar (1) grantet dhe financimin dhe (2) etikën profesionale dhe konfliktet e interesit. Gjithashtu, një tregues i ri u shtua në shtyllën e Informimit dhe Pjesëmarrjes publike në lidhje me ndërmarrjet publike dhe institucionet vartëse.

Për Indeksin e Transparencës në Prokurimin Publik për vitin 2020, KDI ka vlerësuar transparencën institucionale të komunave të Kosovës kundrejt 41 treguesve, të grupuar në gjashtë shtylla tematike. Në

vitin 2019, dy tregues u hoqën nga metodologjia e përdorur në vitin 2018. Një tregues lidhet me platformën qendrore për prokurimet publike, pasi kjo është një kërkesë e detyrueshme për të gjitha autoritetet kontraktuese, dhe treguesi i dytë kishte të bënte me publikimin e legjislacionit që rregullon ndërmarrjet publike, pasi kjo është e zbatueshme vetëm për komunat më të mëdha. Metodologjia e përdorur në vitin 2020 është thjesht reflektim i metodologjisë së përdorur në vitin 2019.

Meqenëse numri i treguesve dhe pikëve për tregues nuk japin rezultat maksimal të kombinuar prej 100, rezultati i ponderuar është përdorur për rezultatet numerike që i mundësojnë KDI-së ta rangojë performancën bazuar në kategoritë e niveleve të ndryshme të prioritetëve ose rëndësisë. Numri i treguesve, pikët maksimale për treguesit për shtyllë dhe pesha e secilës shtyllë janë paraqitur në tabelën më poshtë.

<sup>4</sup> Grupi i Fokusit i mbajtur më 15.03.2018 me përfaqësues nga Qeveria, Agjencitë e Donatorëve dhe Shoqëria Civile



|||||

Shtylla	Numri i treguesve	Pikët totale të treguesve	Pikët maksimale të ponderuara sipas shtyllës
<b>SHTYLLA I</b> - Prokurimi publik (duke përfshirë ankandet publike):	14	20	30
<b>SHTYLLA II</b> - Transparenca buxhetore:	8	16	25
<b>SHTYLLA III</b> - Qasja në dokumente publike:	4	4	10
<b>SHTYLLA IV</b> - Informimi dhe pjesëmarrja e publikut:	7	10	15
<b>SHTYLLA V</b> - Grantet dhe financimi:	4	8	10
<b>SHTYLLA VI</b> - Etika profesionale dhe konflikti i interesit:	4	8	10
<b>TOTAL</b>	<b>41</b>	<b>66</b>	<b>100</b>

\*\*\* Të 38 komunat janë informuar me email lidhur me metodologjinë e re, treguesit dhe poentimin<sup>5</sup>.

<sup>5</sup> E-mail u është dërguar të gjithë Kryetarëve të Komunave më 26 maj 2020

|||||



**Treguesit ndahen në:**

**1. Treguesit e Produktit** – ekzistojnë 29 tregues të produktit që e matin nëse aktivitetet dhe veprimet e planifikuara po zbatohen në të vërtetë siç është paraparë ose siç kërkohet me ligj. Këta tregues mbështeten në të dhënat e nxjerra nga burime të fuqishme dhe të verifikueshme, siç janë faqet e internetit të qeverisë komunale ose qendrore. Këta tregues marrin vlera nga 0 deri në 2 pikë, siç janë shënuar më poshtë:

- 0 Pikë** – që tregojnë se nuk ka informata
- 1 Pikë** – që tregon se informatat janë shpalosur pjesërisht
- 2 Pikë** – që tregojnë se informatat janë shpalosur plotësisht

**2. Treguesit e Performancës** – janë 12 tregues të performancës që e matin cilësinë e performancës. Anketuesit e KDI-së janë mbështetur në këta tregues për t'i krahasuar të dhënat dhe për të përcaktuar një përqindje të performancës. Për t'i krahasuar pikët numerike të treguesve të tjerë, këta tregues janë vlerësuar siç është përshkruar në tabelën e mëposhtme:

KRAHASIMI I TË DHËNAVE KOMUNA KUNDREJT BURIMEVE ALTERNATIVE NË PËRQINDJE											
	1 – 9	10-19	20 - 29	30 - 39	40 - 49	50 - 59	60 - 69	70 - 79	80 - 89	90 - 99	100
<b>PIKËT</b>	0.1	0.2	0.3	0.4	0.5	0.6	0.7	0.8	0.9	1	2



|||||

### Metoda e vlerësimit e përdorur për dhënien e një numri të caktuar pikësh:

- A** Konkluzioni analitik i ekipit hulumtues;
- D** Të siguruarit e standardeve të pajtueshmërisë të miratuara nga UA 01/2015 i MAPL-së<sup>6</sup>, UA 01/2015 i MAP- së<sup>7</sup>, Ligji nr.04/L-042<sup>8</sup>, Ligji nr. 03/L-040<sup>9</sup>, Ligji nr. 03/L-048<sup>10</sup>, Rregullore nr.02/2015 e MPMS-së<sup>11</sup>, dhe Vendimi i Qeverisë nr. 07/87<sup>12</sup>; Rregullorja nr. 04/2015 e Qeverisë së Republikës së Kosovës<sup>13</sup>.
- W** Analiza në faqen e internetit. Hulumtimi tregon qartë se ka informata të mjaftueshme në faqen zyrtare të internetit ose në burime të tjera zyrtare të internetit;
- I** Përgjigjja ndaj letrës për kërkim informacioni;
- T** Të dhënat nga interneti;
- S** Ankesat e qytetarëve, vendimet e gjykatave, artikujt në masmediat me reputacion, dokumentet publike nga OJQ-të (Organizatrat Joqeveritare) dhe deputetët e Kuvendeve Komunale.
- M** Takimet dhe intervistat e drejtpërdrejta me qeverinë lokale dhe qytetarët

6 Udhëzimi administrativ (MAPL) Nr. 01/2015 për transparencë në komuna: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11403>

7 Udhëzimi administrativ (MAP) Nr. 01/2015 për ueb faqet e institucioneve publike: [https://map.rks-gov.net/getattachment/04a69d9b-2b96-4ef2-bfc7-4c82cb860384/Udhezimi-Administrativ-\(MAP\)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx](https://map.rks-gov.net/getattachment/04a69d9b-2b96-4ef2-bfc7-4c82cb860384/Udhezimi-Administrativ-(MAP)-nr-01-2015-per-Ueb-Fa.aspx)

8 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

9 Ligji Nr. 03/L-040 për vetë-qeverisjen lokale: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

10 Ligji Nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>


11 Rregullore (MPMS) Nr.02/2015 për kriteret dhe procedurat e përkrahjes financiare për subvencione dhe grante: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11129>

12 Vendimi i Qeverisë 07/87 për të dhëna të hapura: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet\\_e\\_Mbledhjes\\_se\\_87-te\\_te\\_Qeverise\\_2016.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_87-te_te_Qeverise_2016.pdf)

13 Rregullore (QRK) - nr. 04/2015 për kodin e mirësjelljes në shërbimin civil të Republikës së Kosovës: [http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore\\_QRK\\_Nr.042015\\_per\\_Kodin\\_e\\_Miresjelljes\\_ne\\_Sherbimin\\_Civil\\_te\\_Republikes\\_se\\_Kosoves\\_19.pdf](http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_QRK_Nr.042015_per_Kodin_e_Miresjelljes_ne_Sherbimin_Civil_te_Republikes_se_Kosoves_19.pdf)

|||||



# LISTA E TREGUESVE

Shtylla	Treguesi	Kërkesa Ligjore	Produkti	Lloji i treguesit	Vlerësimi i treguesit
 <p>Prokurimi publik (duke përfshirë ankandet publike)</p>	1	A publikohet plani i prokurimit në faqen e internetit	UA 01/2015 i MAP-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	2	A ka ndonjë listë të të gjitha organeve ekzekutive, institucioneve publike dhe organizatave të cilat i rregullojnë ose trajtojnë kështillat dhe kontestet e prokurimit	UA 01/2015 i MAP-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	3	A publikohet në faqen e internetit raporti vjetor i prokurimit për vitin e kaluar	UA 01/2015 i MAP-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	4	Njoftimet për tenderë publikohen në faqen e internetit të komunës	Neni 12 i UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	5	Njoftimet për dhënie të kontratës publikohen në faqen e internetit të komunës	Neni 12 i UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	6	Numri i njoftimeve për tenderë në faqen e internetit të komunës	Neni 12 i UA 01/2015 i MAPL-së	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës A, D, W
	7	Numri i njoftimeve për tenderë në faqen e internetit të KRPP-së	Neni 12 i UA 01/2015 i MAPL-së	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës A, D, W
	8	Numri i njoftimeve për dhënien e kontratave në faqen e internetit të komunës	Neni 12 i UA 01/2015 i MAPL-së	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës A, D, W
	9	Numri i njoftimeve për dhënien e kontratave në faqen e internetit të KRPP-së	Neni 12 i UA 01/2015 i MAPL-së	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës A, D, W

|||||

Shtylla	Treguesi	Kërkesa Ligjore	Produkti	Lloji i treguesit	Vlerësimi i treguesit
<b>SHTYLLA I</b>  Prokurimi publik (duke përfshirë ankandet publike)	A i publikon komuna kontratat në faqen e saj të internetit	Këta tregues janë ilustrativ, për të treguar nëse kontratat janë publikuar nga komuna, dhe sa kontrata, mirëpo ata nuk vlerësohen me pike.	P/J	Tregues i produktit	W
	Number of contracts published on the municipality's web site	Këta tregues janë ilustrativ, për të treguar nëse kontratat janë publikuar nga komuna, dhe sa kontrata, mirëpo ata nuk vlerësohen me pike.	Të dhëna	Tregues kuantitativ	W
	A i publikon komuna vendimet e OSHP-së në faqen e saj të internetit	Rekomandimi i dhënë nga KDI-ja pas vitit 2020	P/J	Tregues i produktit	W
	Numri i vendimeve të OSHP-së të publikuara në faqen e internetit të komunës	Rekomandimi i dhënë nga KDI-ja pas vitit 2020	Të dhëna	Tregues kuantitativ	W
	<b>10</b> Numri i njoftimeve për ankande në faqen e internetit të komunës	Neni 12 i UA 01/2015 i MAPL-së	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës	A, D, W
	<b>11</b> Numri i njoftimeve për ankande në faqen e internetit të KRPP-së	Neni 12 i UA 01/2015 i MAPL-së	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës	A, D, W
	<b>12</b> A publikohen në faqen e internetit të komunës ankesat dhe vendimet e shkallës së parë për procesin e prokurimit	Neni 12 i UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit	D, W
	<b>13</b> Numri i vendimeve/përgjigjeve për ankesat e shkallës së parë për procesin e prokurimit të publikuara në faqen e internetit	Neni 12 i UA 01/2015 i MAPL-së	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës	A, D, W
	<b>14</b> Numri i vendimeve/përgjigjeve për ankesat e shkallës së parë për procesin e prokurimit, informatat nga komuna	Neni 12 i UA 01/2015 i MAPL-së	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës	A, D, W

|||||

Shtylla	Treguesi	Kërkesa Ligjore	Produkti	Lloji i treguesit	Vlerësimi i treguesit
 <p><b>SHTYLLA II</b></p> <p>Transparenca Buxhetore</p>	1	A publikohet plani i investimeve në faqen e internetit	UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	2	A publikohet buxheti në faqen e internetit	UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	3	A publikohen ndryshimet në buxhet në faqen e internetit	UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	4	A publikohen raportet tremujore të shpenzimeve në faqen e internetit	UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	5	A publikohet raporti përmbledhës i buxhetit të komunës për vitin paraprak fiskal në faqen e internetit	UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	6	A publikohen kornizat buxhetore afatmesme në faqen e internetit	UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	7	A publikohet raporti i auditorit në faqen e internetit	UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit D, W
	8	A publikohet raporti vjetor i subvencioneve në faqen e internetit	Qeverisja e mirë	P/J	Tregues i produktit D, W
 <p><b>SHTYLLA III</b></p> <p>Qasja në dokumentet publike</p>	1	Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike	UA 01/2015 i MAPL-së (Neni 9)	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës I
	2	Numri i kërkesave të refuzuara dhe heshtja administrative (mospërgjigja)	UA 01/2015 i MAPL-së (Neni 9)	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës I
	3	Numri i kërkesave që lidhen me prokurimin publik	UA 01/2015 i MAPL-së (Neni 9)	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës I
	4	Numri i kërkesave të refuzuara lidhur me prokurimin publik	UA 01/2015 i MAPL-së (Neni 9)	Të dhëna kualitative	Tregues i performancës I

|||||

Shtylla	Treguesi	Kërkesa Ligjore	Produk-ti	Lloji i treguesit	Vlerësimi i treguesit	
<b>SHTYLLA IV</b>  Informimi dhe pjesëmarrja e publikut	1	A janë sesionet e hapjes së tenderëve të hapura për publikun	LPP 04/L-042	P/J	Tregues i produktit	D, I
	2	Sa shpesh e përdorin qytetarët faqen e internetit të komunës	Qeverisja e mire	Numri	Tregues kuantitativ	T
	3	A publikohet draft buxheti për konsultime publike	UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit	D, W
	4	A publikohen draft vendimet dhe/ose agjendat për konsultime me publikun	UA 01/2015 i MAPL-së	P/J	Tregues i produktit	D, W
	5	A mund t'ia dërgoni komunës një kërkesë online	UA 01/2015 i MAP-së	P/J	Tregues i produktit	D, W
	6	Numri i dëgjimeve publike (minimum 2 në vit)	UA 01/2015 i MAPL-së	Të dhëna	Tregues kuantitativ	I, W
	7	A publikohet skema organizative që përfshin ndërmarrjet publike dhe institucioneve vartëse në faqen e internetit	UA 01/2015 i MAP-së	P/J	Tregues i produktit	D, W
<b>SHTYLLA V</b>  Grantet dhe financimi	1	A publikohen rregulloret për dhënien e granteve në faqen e internetit	Ligji nr. 03/L-040, Ligji nr. 03/L-048 UA 01/2015 I MAP-së	P/J	Tregues i produktit	D, W
	2	A publikohen thirrjet për aplikime për grante në faqen e internetit	Rregullorja nr. 02/2015 e MPMS-së	P/J	Tregues i produktit	D, W
	3	A publikohen rezultatet e dhënies së granteve në faqen e internetit	Rregullorja nr. 02/2015 e MPMS-së	P/J	Tregues i produktit	D, W
	4	A ka informata për procesin e vlerësimit të projekteve	Rregullorja Nr. 02/2015 e MPMS-së	P/J	Tregues i produktit	D, W

|||||

Shtylla	Treguesi	Kërkesa Ligjore	Produkti	Lloji i treguesit	Vlerësimi i treguesit
<b>SHTYLLA VI</b>  Etika profesionale dhe konflikti i interesit	1	A ka komuna Kod të Etikës?	Ligji nr. 03/L-040	P/J	Tregues i produktit I, D
	2	A publikohet plani i integritetit në faqen e internetit	Ligji nr. 03/L-040	P/J	Tregues i produktit D, W
	3	A ka instrument për raportimin e sjelljeve joetike, diskriminimit ose konfliktit të interesave	RREGULLORJA (QRK) - NR. 04/2015	P/J	Tregues i produktit I, D
	4	A publikohen përkatësitë politike ose anëtarësitë në parti politike të anëtarëve të kuvendit në faqen e internetit	UA 01/2015 i MAP-së	P/J	Tregues i produktit D, W





# ANALIZA KRAHASIMORE 2015-2020

Në vitin 2018, KDI-ja prezantoi një metodologji të rishikuar që mat gjashtë shtylla që kanë të bëjnë me prokurimin publik, shpenzimet publike dhe instrumentet për adresimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit në qeverisjen lokale. E njëjta metodologji është përdorur për masat e vitit 2020. Megjithëse KDI-ja e modifikoi metodologjinë për të matur transparencën në prokurimin publik në nivelin e qeverisjes lokale duke prezantuar gjashtë shtylla dhe 41 tregues, ajo prapë i ka mbajtur 19 treguesit fillestarë që janë përdorur në vitet e mëparshme, për t'i mundësuar hulumtuesve të vazhdojnë t'i matin trendet kohore kundrejt atyre 19 treguesve.

1

Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike, në çdo fushë;

2

Numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike, në çdo fushë;

3

Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike në prokurimin publik;

4

Numri i kërkesave të refuzuara për qasje në dokumente publike në fushën e prokurimit publik;

5

Publikimi i buxhetit të miratuar në faqen e internetit të komunës;

6

Publikimi i planit të prokurimit në faqen e internetit të komunës;

7

Publikimi i raportit të auditimit në faqen e internetit të komunës;

8

Numri i seancave dëgjimore publike;

9

Publikimi i raporteve financiare tremujore dhe gjysmë-vjetore/vjetore në faqen e internetit;

10

Numri i tenderëve të publikuar në faqen e internetit të komunës (njoftimet për kontratë);

11

Numri i tenderëve të publikuar në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;

12

Numri i kontratave të dhëna të publikuara në faqen e internetit të komunës (njoftimet për dhënien e kontratës);

13

Numri i kontratave të dhëna të publikuara në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;

14

Njoftime për shpalljen e ankandit publik në faqen e internetit të komunës;

15

Njoftime për shpalljen e ankandit publik në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;

16

Njoftimi i fituesve të ankandit në faqen e internetit të komunës;

17

Njoftimi i fituesve të ankandit në faqen e internetit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik;

18

Numri i kërkesave/ankesave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë për t'i shqyrtuar dhënien e kontratave;


19

Numri i vendimeve (përgjigjeve) për kërkesat për rishikim.



Grafiku më poshtë tregon trendet e transparencës në prokurimin publik gjatë viteve 2014-2020.


**Transparenca në Prokurim krahasimi përgjatë viteve 2015-2020**






Përveç kësaj, komunat gjithashtu treguan një ndryshim prej **-11%** në transparencën buxhetore në krahasim me vitin 2019 (nga 82% në vitin 2019 në 71% në vitin 2020). Grafiku më poshtë tregon trendet e transparencës përgjatë viteve 2014-2020.

### Transparenca Buxhetore 2015-2020




Grafiku i mëposhtëm tregon trendet e transparencës përgjatë viteve 2015 - 2020 në publikimin e njoftimeve për ankande nga komunat.

**Trendet e publikimit të ankandeve publike në uebfaqen e komunës 2015-2020**




**Kërkesat për qasje në dokumentet publike**





## Kërkesat për qasje në dokumentet publike që kanë të bëjnë me prokurimin publik



Siç mund ta shohim nga grafikët e mësipërm, në vitin 2020, kishte rritje mesatare të transparencës prej **22%** në **19** treguesit e përmendur më lart.


- 1 Në vitin 2020, ka pasur ndryshim prej **-16%** në transparencën në prokurimin publik në krahasim me vitin 2019 (nga 66% në 51%).
- 2 Për më tepër, ka pasur një **ndryshim** në transparencën buxhetore prej **-11%**, nga 82% sa ishte në vitin 2019, në 71% në vitin 2020.
- 3 Në publikimin e njoftimeve për ankande për vitin 2020, 26 njoftime u botuan në faqet e internetit të komunave, por vetëm 7 në faqet e internetit të KRPP-së siç kërkohet nga korniza ligjore.
- 4 Në krahasim me vitin 2019, numri i kërkesave për qasje në dokumente që kanë të bëjnë me prokurimin publik në vitin 2020 **është ulur** për gjithsej **175 kërkesa**.



# ANALIZA KRAHASIMORE 2018-2020

Metodologjia e përdorur në vitin 2020 është thjesht reflektim i metodologjisë së përdorur në vitet 2018 dhe 2019. Kjo ka siguruar bazën për krahasim të performancës së transparencës komunale në shtyllat e njëjta gjatë periudhës 2018-2020.

Indeksi tregon që në vitin 2020 kemi pasur ndryshime pozitive të transparencës në tre nga gjashtë shtyllat, ndryshime negative në dy shtylla dhe një ka mbetur e njëjtë, si në vijim:



Transparenca mesatare komunale në gjashtë shtylla të matura ka pasur një ndryshim prej -1%, nga 70% sa ishte në vitin 2019, në 69% në vitin 2020.



# SHTYLLA I

## Transparenca në prokurimin publik

Indeksi i Transparencës në Qeverisjen Komunale mat, në Shtyllën 1, transparencën në prokurimin publik. Në vitin 2020, 33% e buxhetit publik të Kosovës është shpenzuar nëpërmjet prokurimit publik<sup>14</sup>. Megjithatë, ky proces në Kosovë shpesh përshkruhet si i prirur ndaj korrupsionit<sup>15</sup>.

Për të vlerësuar nivelin e transparencës në këtë shtyllë, KDI ka matur 14 tregues<sup>16</sup> të ndërlidhur drejtpërdrejt me aktivitetet e prokurimit publik në të 38 komunat në Kosovë.

Pikët maksimale që mund të arrihen në këtë shtyllë janë 30, ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela në anën e djathtë tregon radhitjen e komunave sipas rezultateve individuale në këtë shtyllë.

**Rezultati mesatar** për të gjitha komunat është **57%**, i cili mbetet në të njëjtin nivel me vitin 2019. Edhe pse të gjitha komunat e shfrytëzojnë platformën e prokurimit elektronik e-Prokurimi, ekzistojnë disa dokumente të rëndësishme, si raportet e studimit të fizibilitetit (kur është e aplikueshme), raportet e vlerësimit të ofertave, planet për menaxhimin e kontratës dhe faturat që nuk publikohen në platformën qendrore apo uebfaqet lokale.

Megjithatë, shkalla e publikimit të planeve të prokurimit, raporteve vjetore të prokurimit për vitin paraprak, njoftimet për tender, njoftimet për dhënie të kontratës dhe njoftimet për ankande janë duke u përmirësuar deri në një masë, edhe pse ende ka hapësirë për paktueshmëri më të madhe.

Sidoqoftë, për të arritur rezultate maksimale në këtë shtyllë, komunat duhet të demonstrojnë përpjekje shtesë për të siguruar që të gjitha njoftimet për kontratë dhe njoftimet për dhënie të kontratës publikohen në uebfaqet e tyre, jo vetëm në platformën kombëtare e-Prokurimi, pasuar nga publikimi i pretendimeve dhe vendimeve të shkallës së parë për shqyrtime të prokurimit.

<sup>14</sup> Raporti Vjetor i KRPP-së për Prokurimin Publik për vitin 2019

<sup>15</sup> Prokurimi Publik në Ballkanin Perëndimor, Gjykata Evropiane e Auditorëve, 2018

<sup>16</sup> Shikoni pjesën për Metodologjinë


#	Komuna	Pikët
1	Lipjan	30.00
1	Prishtinë	30.00
3	Mamushë	28.50
3	Rahovec	28.50
3	Vushtrri	28.50
6	Gjakovë	27.00
6	Istog	27.00
6	Junik	27.00
6	Pejë	24.00
6	Shtime	24.00
6	Suharekë	24.00
12	Glllogoc	23.85
13	Gjilan	22.50
14	Podujevë	22.35
15	Deçan	21.45
16	Ferizaj	21.00
16	Klinë	21.00
18	Kamenicë	20.85
19	Skenderaj	20.40
20	Prizreni	20.25
21	Mitrovicë e Jugut	17.10
22	Hani i Elezit	16.35
23	Klllokot	15.00
24	Viti	14.25
25	Graçanicë	13.50
25	Kaçanik	13.50
27	Obiliq	12.00
28	Dragash	11.40
29	Novo Bërdë	6.75
30	Leposaviq	6.00
30	Malishevë	6.00
30	Zvecan	6.00
33	Shtërpcë	4.65
34	Fushë Kosovë	3.00
34	Mitrovicë e Veriut	3.00
34	Partesh	3.00
37	Ranillug	3.00
37	Zubin Potok	3.00



|||||

Në grafikun në vijim është paraqitur situata aktuale e përgjithshme për të gjitha komunat në këtë proces, sipas aktivitetit dhe në krahasim me trendet e transparencës midis viteve 2019 dhe 2020:

### TRANSPARENCA NË PROKURIM PRUBLIK PËR INDIKATOR (%) 2019 - 2020



- 28 nga 38 komuna kanë publikuar planet e tyre të prokurimit në ueb faqet e tyre;
- 18 nga 38 komuna kanë publikuar një listë të të gjitha organeve ekzekutive, institucioneve publike dhe organizatave që i rregullojnë ose trajtojnë këshillat dhe mosmarrëveshjet e prokurimit në ueb faqet e tyre;
- 21 nga 38 komuna kanë publikuar raportin vjetor të prokurimit nga viti paraprak në ueb faqet e tyre;
- 22 nga 38 komuna kanë publikuar të gjitha njoftimet për kontratë, dhe 6 kanë publikuar pjesërisht njoftimet për kontratë në ueb faqet e tyre;
- 16 nga 38 komuna kanë publikuar njoftimet për dhënien e kontratës dhe 12 kanë publikuar pjesërisht njoftimet për dhënien e kontratës në ueb faqet e tyre;
- 11 nga 38 komuna kanë publikuar njoftimet për ankande publike në ueb faqet e tyre;
- 18 nga 38 komuna kanë publikuar vendimet e autoritetit kontraktues lidhur me ankesat e shkallës së parë nga operatorët ekonomikë në ueb faqet e tyre.

|||||

# Planifikimi i prokurimit në faqen e internetit

Përmes procesit të planifikimit të prokurimit, vendimmarrësit komunal përcaktojnë metodat e prokurimit dhe pritjet për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Planifikimi i prokurimit është i rëndësishëm sepse një plan i prokurimit rendit të gjitha kërkesat e pritura që do të blihen gjatë një periudhe kohore, përcakton afatin kohor për përfundimin e prokurimeve dhe ofron vlerësime mbi aktivitetet e prokurimit. Indeksi tregon se 28 nga 38 komuna kanë publikuar planet e tyre të prokurimit në faqet e tyre të internetit.

Më poshtë është lista e komunave që kanë publikuar planifikimin e tyre përfundimtar të prokurimit për vitin 2020 në faqet e tyre të internetit:

- |                |                      |              |
|----------------|----------------------|--------------|
| 1 Deçan        | 11 Klinë             | 21 Prishtinë |
| 2 Drenas       | 12 Kllokot           | 22 Prizren   |
| 3 Ferizaj      | 13 Lipjan            | 23 Rahovec   |
| 4 Gjakovë      | 14 Malishevë         | 24 Shtime    |
| 5 Gjilan       | 15 Mamushë           | 25 Skënderaj |
| 6 Graçanicë    | 16 Mitrovicë e Jugut | 26 Suharekë  |
| 7 Han i Elezit | 17 Novobërdë         | 27 Viti      |
| 8 Istog        | 18 Obiliq            | 28 Vushtrri  |
| 9 Junik        | 19 Pejë              |              |
| 10 Kamenicë    | 20 Podujevë          |              |




## Transparenca në aktivitetet tenderuese

Për të vlerësuar nivelin e transparencës në tenderim, KDI ka krahasuar gjashtë treguesit e performancës në vijim, me qëllim të ilustrimit të dallimit ndërmjet faqeve të internetit të komunave dhe njoftimeve që këto institucione kanë publikuar në faqen e internetit të KRPP-së:

- 1 Numri i njoftimeve për tenderë në faqen e internetit të komunës;
- 2 Numri i njoftimeve për tenderë në faqen e internetit të KRPP-së (e-Prokurimi);
- 3 Numri i njoftimeve për dhënien e kontratës në faqen e internetit të komunës;
- 4 Numri i njoftimeve për dhënien e kontratës në faqen e internetit të KRPP-së (e-Prokurimi);
- 5 Numri i njoftimeve për ankand në faqen e internetit të komunës;
- 6 Numri i njoftimeve për ankand në faqen e internetit të KRPP-së (e-Prokurimi).


## Njoftimet për kontratë

Numri i tenderëve të publikuar në faqet e internetit të komunave zakonisht dallon nga numri i tenderëve të publikuar në platformën zyrtare të prokurimit qendror (e-Prokurimi). Në vitin 2020, 77% e njoftimeve për tenderët e qeverisë lokale u publikuan në faqet e internetit të komunave, gjë që shënon një ndryshim prej +9% në transparencë krahasuar me vitin e kaluar (68%). Nga 2,759 njoftime të tenderit që janë publikuar në platformën e-Prokurimi, 2,115 prej tyre janë publikuar gjithashtu në faqet e internetit të komunave.



## Njoftimet për dhënie të kontratës

Lidhur me njoftimet për dhënie të kontratës, nga 2,940 njoftime të publikuara në platformën e-Prokurimi, 2,117 prej tyre janë publikuar edhe në faqet e internetit të komunave. Kjo paraqet 72% të njoftimeve për dhënie të kontratës. Në krahasim me vitin paraprak (69% në vitin 2019), viti 2020 ka shënuar një ndryshim prej +3% të transparencës në këtë tregues.



2020 ka shënuar një ndryshim prej


**3%**

të transparencës në këtë tregues.




Tabelat në vijim ilustrojnë nivelin e transparencës në prokurim për të gjitha komunat e Kosovës:

**Krahasimi i tenderëve të publikuar ndërmjet faqes së internetit të KRPP-së dhe atyre të komunave**



■ Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqe të komunës  
 ■ Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqe të KRPP-së

**Krahasimi i publikimit të njoftimeve për dhënie të kontratës**



■ Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqe të komunës  
 ■ Numri i tenderëve të publikuar në ueb faqe të KRPP-së



INDEKSI I TRANSPARENCËS PËR QEVERISJEN KOMUNALE 2020

|||||

Komunat që publikojnë më shumë se 50% të njoftimeve të tyre për kontrata dhe njoftimeve për dhënie të kontratave janë:

#	Komuna	NJOFTIMET PËR KONTRATA	NJOFTIMET PËR DHËNIEN E KONTRATAVE	PËRQINDJA E KOMBINUAR
		Janar-Dhjetor 2020	Janar-Dhjetor 2020	
1	Gjakovë	100%	100%	100%
2	Istog	100%	100%	100%
3	Junik	100%	100%	100%
4	Kaçanik	100%	100%	100%
5	Klinë	100%	100%	100%
6	Lipjan	100%	100%	100%
7	Pejë	100%	100%	100%
8	Prishtinë	100%	100%	100%
9	Suharekë	100%	100%	100%
10	Gjilan	98%	100%	99%
11	Vushtrri	98%	100%	99%
12	Rahovec	100%	94%	97%
13	Ferizaj	96%	96%	96%
14	Shtime	97%	94%	96%
15	Mamushë	100%	91%	95%
16	Podujevë	98%	89%	93%
17	Drenas	100%	82%	91%
18	Hani i Elezit	94%	85%	90%
19	Deçan	100%	74%	87%
20	Dragash	100%	55%	78%
21	Skënderaj	54%	100%	77%
22	Viti	80%	59%	69%
23	Prizren	62%	69%	65%
24	Mitrovicë e Jugut	72%	58%	65%

|||||

# Publikimi i kontratave të nënshkuara dhe vendimeve të OSHP-së

Në vitin 2018, disa komuna filluan publikimin e kontratave në faqet e tyre të internetit. Ky numër i komunave filloi të rritej gjatë dy viteve të ardhshme 2019 dhe 2020. Për më tepër, në 2020 KDI u kishte rekomanduar të gjitha komunave që të fillojnë të publikojnë vendimet e OSHP-së që kanë të bëjnë me veprimet e tyre të prokurimit. Publikimi i kontratave dhe vendimeve të OSHP-së në faqet e internetit të komunave nuk janë kërkesë ligjore, megjithatë kjo praktikë njihet si një qeverisje e mirë nga komunat. Edhe pse Indeksi ilustron komunat që kanë treguar këtë praktikë të mirë dhe numrin e kontratave të publikuara dhe vendimet e OSHP-së, këto praktika nuk marrin pikë në indeks.

Megjithëse sipas legjislacionit aktual<sup>17</sup>, të gjithë autoritetet kontraktuese do të publikojnë kontratat e tyre në platformën qendrore të prokurimit e-prokurimit, shumica e komunave vazhduan të ndjekin trendin e publikimit të kontratave në faqet e internetit të komunave të tyre. Gjatë vitit 2020, 25 komuna publikuan kontrata në faqet e tyre të internetit, siç renditen më poshtë (sipas rendit alfabetik):

#	Komuna	# i kontratave të publikuara	#	Komuna	# i kontratave të publikuara
1	Deçan	42	14	Mitrovicë e Jugut	19
2	Dragash	120	15	Obiliq	74
3	Drenas	141	16	Pejë	103
4	Ferizaj	166	17	Podujevë	111
5	Gjakovë	128	18	Prishtinë	219
6	Gjilan	59	19	Prizren	193
7	Han i Elezit	48	20	Rahovec	96
8	Istog	147	21	Shtime	77
9	Junik	24	22	Skenderaj	90
10	Kaçanik	16	23	Suharekë	200
11	Lipjan	146	24	Viti	56
12	Malishevë	39	25	Vushtrri	105
13	Mamushë	29			

<sup>17</sup> Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik



Dymbëdhjetë komunat vijuese kanë publikuar vendimet e OSHP-së që kanë të bëjnë me veprimet e tyre të prokurimit në faqet e tyre të internetit:

- |           |          |             |
|-----------|----------|-------------|
| 1 Deçan   | 5 Istog  | 9 Prishtinë |
| 2 Ferizaj | 6 Junik  | 10 Prizren  |
| 3 Gjakovë | 7 Lipjan | 11 Rahovec  |
| 4 Gjilan  | 8 Pejë   | 12 Vushtrri |



Publikimi i kontratave dhe vendimeve të OSHP-së në faqet e internetit të komunave nuk janë kërkesë ligjore, megjithatë kjo praktikë njihet si një qeverisje e mirë nga komunat.






# Transparenca në ankandet publike

Në Kosovë, numri i ankandeve publike është mjaft i vogël krahasuar me numrin e përgjithshëm të prokurimeve publike. Artikujt e shitur përmes ankandeve nuk kanë vlerë të lartë monetare; megjithatë, publikimi i këtyre aktiviteteve në faqet e internetit të komunave është kërkesë ligjore e Ligjit nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Për më tepër, procedurat për njoftimet dhe dhëniet e ankandit publik rregullohen përmes legjislacionit sekondar për prokurimin publik, dhe për këtë arsye, kërkohet edhe publikimi i tyre në faqen e internetit të KRPP-së.

Për të matur nivelin e transparencës në këtë proces, Indeksi krahasoi dy treguesit e mëposhtëm:

1. Numrin e njoftimeve për ankande në faqen e internetit të komunës nga janari deri në dhjetor të vitit 2020;
2. Numrin e njoftimeve për ankande në faqet e internetit të KRPP-së dhe e-Prokurimit nga janari deri në dhjetor të vitit 2020.



●

**Procedurat për njoftimet  
dhe dhëniet e ankandit  
publik rregullohen përmes  
legjislacionit sekondar për  
prokurimin publik, dhe për këtë  
arsye, kërkohet edhe publikimi  
i tyre në faqen e internetit të  
KRPP-së.**

●

Më poshtë është lista e komunave që kanë publikuar thirrjet e tyre për ankande në faqet e tyre të internetit:

- |           |            |             |
|-----------|------------|-------------|
| 1 Dragash | 5 Kaçanik  | 9 Novobërdë |
| 2 Drenas  | 6 Kamenicë | 10 Podujevë |
| 3 Ferizaj | 7 Klinë    | 11 Suharekë |
| 4 Gjakovë | 8 Lipjan   |             |



# Informacione mbi ankesat e shkallës së parë në lidhje me procesin e prokurimit publik

Ky Tregues merret me procesin e shqyrtimit të prokurimit (ose protestës për ofertë). KDI ka matur transparencën e ankesave të shkallës së parë - domethënë ankesat e adresuara nga vetë komunat para se të përshkallëzohen tek Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP). Ligji i Prokurimit Publik u ndryshua me Ligjin nr. 05/L-068 që hyri në fuqi në janar të vitit 2016, duke autorizuar vetë autoritetet kontraktuese, përfshirë edhe komunat, të shërbejnë si shkallë e parë e shqyrtimit të ankesave të prokurimit.

Sipas informacioneve të siguruara nga komunat, në vitin 2020, bazuar në 32 përgjigjet e komunave, operatorët ekonomikë kanë paraqitur 549<sup>18</sup> ankesa të shkallës së parë në lidhje me aktivitetet e prokurimit. Më poshtë është lista e komunave që publikojnë këto ankesa/vendime në faqen e tyre të internetit:

- |           |             |              |
|-----------|-------------|--------------|
| 1 Deçan   | 7 Kamenicë  | 13 Prishtinë |
| 2 Gjakovë | 8 Klinë     | 14 Prizren   |
| 3 Gjilan  | 9 Lipjan    | 15 Rahovec   |
| 4 Drenas  | 10 Mamushë  | 16 Shtime    |
| 5 Istog   | 11 Pejë     | 17 Suharekë  |
| 6 Junik   | 12 Podujevë | 18 Vushtrri  |

---

18 Informacioni i marrë nga komunat si përgjigje ndaj hetimit të informacionit publik



Këto komuna kanë publikuar 404 vendime për këto ankesa në faqet e tyre të internetit.



Përderisa shumica e komunave publikojnë dokumente që kanë të bëjnë me prokurimin publik, janë katër komuna që nuk publikojnë asnjë dokumentacion në lidhje me këtë proces. Informacioni për aktivitetet e tyre është në dispozicion vetëm në platformën e prokurimit të qeverisë qendrore.

- 1 Zveçan
- 2 Leposaviq
- 3 Mitrovicë e Veriut
- 4 Zubin Potok

# SHTYLLA II:

## Transparenca buxhetore

Për të matur transparencën buxhetore, KDI ka përdorur treguesit e mëposhtëm:

1. A është publikuar plani komunal i investimeve në faqen e internetit?
2. A është publikuar buxheti komunal në faqen e internetit?
3. A janë publikuar ndryshimet në ndarjet buxhetore në faqen e internetit?
4. A janë publikuar raportet tremujore të shpenzimeve në faqen e internetit?
5. A është publikuar raporti përmbledhës vjetor për buxhetin e komunës për vitin paraprak fiskal në faqen e internetit?
6. A janë publikuar dokumentet e kornizës afatmesme buxhetore në faqen e internetit?
7. A është publikuar raporti i auditimit të jashtëm në faqen e internetit?
8. A është publikuar raporti vjetor për subvencionet në faqen e internetit?

Pikët maksimale në këtë seksion janë 25 ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela në të djathtë tregon renditjen e komunave sipas pikëve individuale në këtë shtyllë. Rezultati mesatar për transparencë buxhetore është **61%**.


Në krahasim me vitin e kaluar (2019), komunat kanë pasur një ndryshim në transparencën e buxhetit me -12%, nga 73% në vitin 2019 në 61% në vitin 2020.

Rënia më e lartë e transparencës në këtë shtyllë është shënuar në publikimin e planit të investimeve (-24%) dhe ndryshimin e ndarjeve buxhetore (-42%).

#	Komuna	Pikët
1	Gjakovë	25.00
1	Lipjan	25.00
1	Prishtinë	25.00
3	Dragash	21.88
3	Drenas	21.88
3	Ferizaj	21.88
3	Han i Elezit	21.88
3	Junik	21.88
3	Malishevë	21.88
3	Rahovec	21.88
3	Vushtrri	21.88
12	Deçan	20.31
13	Kllokot	18.75
13	Mitrovicë	18.75
13	Podujevë	18.75
13	Prizren	18.75
13	Shtime	18.75
13	Skenderaj	18.75
19	Fushë Kosovë	15.63
19	Graçanicë	15.63
19	Kamenicë	15.63
19	Obiliq	15.63
19	Pejë	15.63
19	Suharekë	15.63
19	Viti	15.63
26	Gjilan	12.50
26	Istog	12.50
26	Kaçanik	12.50
26	Klinë	12.50
26	Mamushë	12.50
31	Ranillug	9.38
31	Shtërpçë	9.38
33	Novobërdë	6.25
34	Leposaviq	0.00
34	Mitrovicë e Veriut	0.00
34	Partesh	0.00
34	Zubin Potok	0.00
34	Zveçan	0.00

Grafiku i mëposhtëm tregon performancën sipas treguesve:


**TRANSPARENCA BUXHETORE PËR TREGUES (%)**





Grafiku i mëposhtëm ilustron trendet e transparencës buxhetore për vitet 2019 - 2020:

### Transparenca në buxhetin komunal për tregues (%) 2019 - 2020





# Publikimi i planit të investimeve në faqen e internetit

Sipas Udhëzimit Administrativ 01/2015 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), të gjitha komunat janë të detyruara me ligj të publikojnë planin e investimeve. Në vitin 2020, 19 nga 38 komuna publikuan planet e tyre të investimeve në faqet e tyre të internetit. Më poshtë është lista e komunave që e kanë përmbushur këtë kërkesë ligjore:


- |                |                      |              |
|----------------|----------------------|--------------|
| 1 Deçan        | 8 Han i Elezit       | 14 Podujevë  |
| 2 Dragash      | 9 Junik              | 15 Prishtinë |
| 3 Drenas       | 10 Klllokot          | 16 Prizren   |
| 4 Ferizaj      | 11 Lipjan            | 17 Rahovec   |
| 5 Fushë Kosovë | 12 Malishevë         | 18 Skënderaj |
| 6 Gjakovë      | 13 Mitrovicë e Jugut | 19 Vushtrri  |
| 7 Graçanicë    |                      |              |

Komunat të cilat publikojnë planin e investimeve në ueb faqe

**19**

Komunat të cilat NUK e publikojnë planin e investimeve në ueb faqe


**19**





# Publikimi i buxhetit të miratuar në faqen e internetit

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, 26 komuna i kanë publikuar planet e tyre buxhetore në faqet e tyre të internetit. Ky është një ndryshim në transparencë me **-14%** krahasuar me vitin paraprak, nga 82% në vitin 2018 në 68% në vitin 2020.



Më poshtë është lista e komunave që publikuan buxhetin në vitin 2020:

- |                |                      |              |
|----------------|----------------------|--------------|
| 1 Deçan        | 10 Junik             | 19 Podujevë  |
| 2 Dragash      | 11 Kaçanik           | 20 Prishtinë |
| 3 Drenas       | 12 Kllokot           | 21 Prizren   |
| 4 Ferizaj      | 13 Lipjan            | 22 Rahovec   |
| 5 Fushë Kosovë | 14 Malishevë         | 23 Skënderaj |
| 6 Gjakovë      | 15 Mamushë           | 24 Suharekë  |
| 7 Graçanicë    | 16 Mitrovica e Jugut | 25 Viti      |
| 8 Han i Elezit | 17 Novobërdë         | 26 Vushtrri  |
| 9 Istog        | 18 Pejë              |              |

## Publikimi i ndryshimeve në ndarjet buxhetore në faqen e internetit

Në vitin 2020, si reagim ndaj pandemisë, Qeveria e Kosovës bëri një ndryshim në Ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2020<sup>19</sup>, me qëllim të zhvendosjes së fondeve në përgjigje të mjeteve shëndetësore dhe të mirëqenies sociale. 19 nga 38 komuna kanë përfituar nga ky ndryshim, megjithatë, vetëm tre komuna (Gjakova, Lipjani dhe Prishtina) publikuan ligjin e ndryshuar për ndarjet buxhetore në faqet e tyre të internetit.

## Publikimi i raporteve financiare tremujore në faqet e internetit

Korniza aktuale ligjore<sup>20</sup> kërkon publikimin e raporteve tremujore dhe vjetore të shpenzimeve nga të gjitha institucionet financiare publike.

Komunat e mëposhtme publikuan raportet e tyre tremujore financiare në faqet e tyre të internetit:

- |                |                      |              |
|----------------|----------------------|--------------|
| 1 Deçan        | 9 Junik              | 16 Prishtinë |
| 2 Dragash      | 10 Kaçanik           | 17 Prizren   |
| 3 Drenas       | 11 Lipjan            | 18 Rahovec   |
| 4 Ferizaj      | 12 Malishevë         | 19 Skënderaj |
| 5 Fushë Kosovë | 13 Mitrovicë e Jugut | 20 Suharekë  |
| 6 Gjakovë      | 14 Pejë              | 21 Viti      |
| 7 Graçanicë    | 15 Podujevë          | 22 Vushtrri  |
| 8 Han i Elezit |                      |              |

19 LIGJI NR. 07/L-014 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT ME NR. 07/L-001 MBI NDARJET BUXHETORE PËR BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN 2020

20 Shih listën e treguesve



# Publikimi i raportit vjetor përmbledhës për buxhetin e komunës për vitin paraprak fiskal në faqen e internetit

Sipas Udhëzimit Administrativ 01/2015 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), të gjitha komunat janë të detyruara me ligj që të publikojnë raportin vjetor përmbledhës për vitin paraprak fiskal në faqet e tyre të internetit. Në vitin 2020, 24 nga 38 komuna kanë publikuar raportin vjetor përmbledhës në faqet e tyre të internetit. Kjo shënon një ndryshim prej -6%, përkatësisht nga 82% në vitin 2019 në 76% në vitin 2020.

Komunat në vijim publikuan raportin vjetor përmbledhës për buxhetin e komunës për vitin paraprak fiskal në faqen e internetit:

- |                |              |              |
|----------------|--------------|--------------|
| 1 Deçan        | 9 Istog      | 17 Podujevë  |
| 2 Dragash      | 10 Junik     | 18 Prishtinë |
| 3 Drenas       | 11 Kaçanik   | 19 Prizren   |
| 4 Ferizaj      | 12 Klllokot  | 20 Rahovec   |
| 5 Fushë Kosovë | 13 Lipjan    | 21 Skënderaj |
| 6 Gjakovë      | 14 Malishevë | 22 Suharekë  |
| 7 Graçanicë    | 15 Mamushë   | 23 Viti      |
| 8 Han i Elezit | 16 Pejë      | 24 Vushtrri  |



# Publikimi i kornizës afatmesme buxhetore në faqen e internetit

Korniza Afatmesme Buxhetore<sup>21</sup> paraqet dokumentin kryesor mbi të cilin bazohet buxheti vjetor dhe jep një analizë të mjedisit makroekonomik në vend për ta krijuar bazën për planifikimin e buxhetit për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Në vitin 2020, 21 nga 38 komuna kanë publikuar kornizën afatmesme buxhetore në faqet e tyre të internetit. Kjo është një rënie prej 2% nga viti i kaluar (2019). Më poshtë është një listë e komunave që botuan KAB:

- |                |                      |              |
|----------------|----------------------|--------------|
| 1 Deçan        | 8 Junik              | 15 Prishtinë |
| 2 Dragash      | 9 Kaçanik            | 16 Prizren   |
| 3 Drenas       | 10 Kllokot           | 17 Rahovec   |
| 4 Ferizaj      | 11 Lipjan            | 18 Skënderaj |
| 5 Gjakovë      | 12 Mitrovicë e Jugut | 19 Suharekë  |
| 6 Han i Elezit | 13 Pejë              | 20 Viti      |
| 7 Istog        | 14 Podujevë          | 21 Vushtrri  |

## Raporti i auditimit në faqen e internetit

Publikimi i raportit të auditimit për vitin 2020 është një tregues tjetër i rëndësishëm sepse ai i jep publikut informata se si menaxhohen fondet publike nga komunat. Në vitin 2020, 27 nga 38 komuna publikuan raportet e auditimit në faqet e tyre të internetit<sup>22</sup>. Transparenca në këtë tregues mbetet e njëjtë si në krahasim me Indeks të Transparençës në Qeverisjen Komunale për vitin 2019. Komunat e mëposhtme kanë publikuar raportin e auditimit në faqet e tyre të internetit:

<sup>21</sup> Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023, Ministria e Financave, <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/0A4862AF-FF68-4C1E-BA9A-BCD1C97BB422.pdf>

<sup>22</sup> Raportet e auditimit për të gjitha komunat janë në dispozicion në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës: <http://zka-rks.org/>



- |                |                      |              |
|----------------|----------------------|--------------|
| 1 Deçan        | 9 Junik              | 17 Prishtinë |
| 2 Dragash      | 10 Kllokot           | 18 Prizren   |
| 3 Drenas       | 11 Lipjan            | 19 Rahovec   |
| 4 Ferizaj      | 12 Malishevë         | 20 Skënderaj |
| 5 Fushë Kosovë | 13 Mamushë           | 21 Suhareka  |
| 6 Gjakovë      | 14 Mitrovicë e Jugut | 22 Viti      |
| 7 Han i Elezit | 15 Pejë              | 23 Vushtrri  |
| 8 Istog        | 16 Podujevë          |              |

## Publikimi i raportit vjetor për subvencionet në faqen e internetit

Publikimi i raportit vjetor mbi subvencionet është një tregues i mirë i qeverisjes. Ky tregues është i rëndësishëm për shkakun që i siguron publikut informacion se si ndahen fondet publike dhe shpërndahen nga komunat në mbështetje të ekonomisë lokale, aktiviteteve kulturore dhe sportive. Në vitin 2020, 14 nga 38 komuna e kanë publikuar raportin vjetor për subvencione në faqet e tyre të internetit. Më poshtë është lista e komunave që publikojnë këtë raport:

- |           |                |                      |
|-----------|----------------|----------------------|
| 1 Deçan   | 6 Han i Elezit | 11 Mitrovicë e Jugut |
| 2 Dragash | 7 Junik        | 12 Prishtinë         |
| 3 Drenas  | 8 Lipjan       | 13 Rahovec           |
| 4 Ferizaj | 9 Malishevë    | 14 Vushtrri          |
| 5 Gjakovë | 10 Mamushë     |                      |



# SHTYLLA III:

## Qasja ne dokumente publike

Në shtyllën 3, indeksi i transparencës mat qasjen në dokumentet publike. Përmes kësaj Shtylle, KDI vëzhgoi shkallën në të cilën zbatohet Ligji për Qasje në Dokumente Publike. Për më tepër, KDI vlerësoi aftësinë e qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave lidhur me përdorimin e këtij mekanizmi për të kërkuar llogaridhënie nga institucionet komunale. Rezultati maksimal në këtë shtyllë është 10 ndërsa rezultati minimal është zero. Dhënia e përgjithshme e përgjigjeve e komunave ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike është në 84%. KDI ka dërguar 38 kërkesa për qasje në informata publik dhe ka marrë një përgjigje komunale nga 32 komuna; gjashtë komuna nuk u përgjigjën. Bazuar në informatat e dhëna nga komunat, nga 843 kërkesa, vetëm 2 ishin refuzuar në bazë të dispozitave juridike për mbrojtjen e të dhënave/konfidencialitetin e informacionit.

### NUMRI I KËRKESAVE PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE TË DËRGUARA NGA KDI TEK KOMUNAT DHE PËRGJIGJET NDAJ TYRE

KOMUNAT	38
KËRKESAT E PARAQITURA PËR QASJE	38
KËRKESAT QË KANË MARRË PËRGJIGJE	32
KËRKESAT QË NUK KANË MARRË PËRGJIGJE	6

### PËRGJEGJSHMËRIA E KOMUNAVE NË KËRKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE(%)

Mesatarja e përgjigjeve	84%
Përgjigjet e komunave ndaj kërkesave pvr qasje në dokumente publike lidhur me prokurimin publik	84%
Përgjigjet e komunave ndaj kërkesave për qasje në dokumente publike	84%

Në këtë Shtyllë, fokusi ishte në kërkesat për qasje në dokumente publike në prokurimin publik. Sipas informatave të ofruara nga komunat në përgjigje të kërkesës nga KDI, qytetarët paraqitën 835 kërkesa për qasje në dokumente publike në 32 komuna që siguruan informacionin për vitin 2020. Nga këto, 327 ishin të lidhura me prokurimin publik. Komunat me numrin më të madh të kërkesave për qasje në dokumente publike ishin Prishtina me 94, Gjakova me 83 dhe Ferizaj me 79 kërkesa për qasje në dokumente publike.

32 nga 38 komuna iu përgjigjën anketës së KDI duke ofruar të dhëna për kërkesën për qasje në dokumente publike, ndërsa shtatë komuna nuk i ofruan ato informata.

### LISTA E KOMUNAVE QË NUK OFRUAN INFORMACIONE LIDHUR ME KËRKESAT PËR QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE

- 1 Graçanicë
- 2 Kllokot
- 3 Mitrovicë e Veriut
- 4 Novobërdë
- 5 Partesh
- 6 Ranillug

# SHTYLLA IV

## Informimi dhe pjesëmarrja e publikut

Për të matur transparencën e ofrimit të informatave për qytetarët që kanë të bëjnë me angazhimin civil dhe informimin, KDI ka përdorur treguesit e mëposhtëm:

1. A janë sesionet e hapjes së tenderëve të hapura për publikun?
2. Sa shpesh e përdorin qytetarët faqen e internetit të komunës?
3. Sa herë e kanë vizituar qytetarët faqen e internetit të komunës?
4. A është publikuar draft buxheti për konsultime publike?
5. A janë publikuar draft vendimet dhe/ose agjendat për konsultime me publikun?
6. A munden qytetarët ta dërgojnë një kërkesë online për komunën?
7. Numri i dëgjimeve buxhetore (min. 2 në vit)?
8. A është skema organizative që përfshin ndërmarrjet publike dhe institucionet vartëse e publikuar në faqen e internetit?

Pikët maksimale të caktuara në këtë shtyllë janë 15 ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela në të djathtë tregon renditjen e komunave sipas pikëve individuale në këtë shtyllë.

Niveli mesatar i transparencës në informimin publik dhe pjesëmarrjen e publikut është 83%.

Përderisa të gjitha sesionet e hapjes së tenderëve janë të hapura për publikun, dhe 89% e komunave kanë ndërtuar module në faqet e tyre të internetit për komunikim të lehtë dhe të drejtpërdrejtë me qytetarët, 71% e komunave publikuan draft buxhetin e tyre për konsultim publik, dhe 76%

#	Komuna	Pikët
1	Drenas	15.00
1	Ferizaj	15.00
1	Gjakovë	15.00
1	Gjilan	15.00
1	Han i Elezit	15.00
1	Istog	15.00
1	Junik	15.00
1	Kaçanik	15.00
1	Kamenicë	15.00
1	Lipjan	15.00
1	Malishevë	15.00
1	Mamushë	15.00
1	Mitrovicë	15.00
1	Obiliq	15.00
1	Partesh	15.00
1	Pejë	15.00
1	Podujevë	15.00
1	Prishtinë	15.00
1	Prizren	15.00
1	Rahovec	15.00
1	Shtime	15.00
1	Skenderaj	15.00
1	Suharekë	15.00
1	Viti	15.00
1	Vushtrri	15.00
26	Graçanicë	12.00
26	Klinë	12.00
26	Novobërdë	12.00
29	Fushë Kosovë	10.50
30	Deçan	9.00
30	Dragash	9.00
30	Shtërpçë	9.00
33	Kllokot	7.50
34	Ranillug	6.00
34	Zvecan	6.00
36	Zubin Potok	3.00
37	Leposaviq	1.50
37	Mitrovicë e Veriut	1.50




gjithashtu i kanë publikuar draft agjendat dhe vendimet për konsultim me qytetarët.

Përveç që u sfiduan me pandeminë COVID-19, dhe kufizimet e mbledhjes dhe lëvizjes, komunat kanë qenë proaktive në përfshirjen e publikut në procesin e vendimmarrjes. Duke respektuar masat shëndetësore të cilat kufizuan numrin e pjesëmarrësve, komunat gjithashtu organizuan dëgjime publike duke përdorur platforma digjitale. Megjithëse punonin me kapacitete të kufizuara dhe duke përdorur të dy metodat (fizike dhe digjitale) në vitin 2020, ato organizuan 162 dëgjime publike që tejkalojnë minimumin e mandatuar ligjërisht prej dy dëgjimeve të tilla publike në vit.

Në vitin 2020, 82% e komunave publikuan organogramët e tyre dhe legjislacionin bazë rregullues për këto subjekte. Edhe pse disa komuna më të vogla nuk kanë në pronësi ndërmarrje publike dhe marrin shërbimet e tyre nga niveli rajonal, qytetarët e tyre janë në kontratë ditore me ofruesit e shërbimeve. Këto shërbime përfshijnë furnizimin me ujë, sistemet e ujërave të zeza, grumbullimin e mbeturinave, etj., për të cilat qytetarët kanë shqetësime të rregullta, pra informacioni se si veprojnë, dhe kush është përgjegjës e në cilin nivel për mbikëqyrjen e tyre, duhet të jetë në dispozicion të qytetarëve. Pandemia ka treguar që interesi publik për qeverisjen komunale ka rënë krahasuar me vitin paraprak (2019) kur faqet e internetit të komunave janë vizituar **6,542,769** herë. Megjithatë, në vitin 2020, faqet e internetit komunale ishin vizituar **4,167,112** herë (duke treguar vizita të shumta të kthimit të 1,248,850 vizitorëve për një vend me një popullsi prej vetëm 1,809,481)..

Grafiku i mëposhtëm tregon krahasimin e transparencës për periudhën 2018 - 2020:

**TRANSPARENCA NË INFORMIM DHE PJESËMARRJE TË PUBLIKUT(%)**







# Qasshmëria dhe konsultimi publik

## SEANCAT E HAPJES SË TENDERËVE

Sipas informacionit të pranuar nga 32 komuna të cilat i janë përgjigjur kërkesës për qasje në informata publike, të gjitha seancat e hapjes së tenderëve janë të hapura për publikun, megjithatë gjashtë komuna treguan se seancat e tenderit janë të hapura me kërkesë paraprake për shkak të kufizimeve të hapësirës. Gjatë seancave të hapjes së tenderit, bizneset konkurruese, qytetarët dhe organizatat monitoruese mund t'i vëzhgojnë procedurat dhe çmimet e ofruara.

## PUBLIKIMI I PROJEKTBUXHETIT PËR KONSULTIME PUBLIKE

Në vitin 2020, 28 komuna publikuan projektbuxhetin për konsultime publike. Më poshtë është lista e komunave që publikuan projektbuxhetin:

- |                |               |              |
|----------------|---------------|--------------|
| 1 Drenas       | 11 Lipjan     | 20 Prishtinë |
| 2 Ferizaj      | 12 Malishevë  | 21 Prizren   |
| 3 Gjakovë      | 13 Mamushë    | 22 Rahovec   |
| 4 Gjilan       | 14 Mitrovicë  | 23 Shtërpcë  |
| 5 Graçanicë    | 15 Novo Bërdë | 24 Shtime    |
| 6 Han i Elezit | 16 Obiliq     | 25 Skënderaj |
| 7 Istog        | 17 Partesh    | 26 Suharekë  |
| 8 Junik        | 18 Pejë       | 27 Viti      |
| 9 Kaçanik      | 19 Podujevë   | 28 Vushtrri  |
| 10 Kamenicë    |               |              |

## PUBLIKIMI I DRAFT VENDIMEVE DHE/OSE AGJENDAVE PËR KONSULTIM ME PUBLIKUN

Në vitin 2020, 28 komuna publikuan projektbuxhetin për konsultime publike. Më poshtë është lista e komunave që publikuan projektbuxhetin:





- |                |              |              |
|----------------|--------------|--------------|
| 1 Ferizaj      | 11 Klinë     | 21 Podujevë  |
| 2 Fushë Kosovë | 12 Kllokot   | 22 Prishtinë |
| 3 Gjakovë      | 13 Lipjan    | 23 Prizren   |
| 4 Gjilan       | 14 Malishevë | 24 Rahovec   |
| 5 Graçanicë    | 15 Mamushë   | 25 Shtërpçë  |
| 6 Han i Elezit | 16 Mitrovicë | 26 Shtime    |
| 7 Istog        | 17 Novobërdë | 27 Skënderaj |
| 8 Junik        | 18 Obiliq    | 28 Suharekë  |
| 9 Kaçanik      | 19 Partesh   | 29 Viti      |
| 10 Kamenicë    | 20 Pejë      | 30 Vushtrri  |

## DËGJIMET PUBLIKE

Përveç sfidave me pandeminë COVID-19, komunat kanë qenë shumë aktive sa i përket dëgjimeve publike në lidhje me aprovimin e buxhetit. Numri i kërkuar i dëgjimeve publike është minimumi dy për çarkoren e buxhetit si pjesë e seancës dëgjimore. Sipas të dhënave të marra nga 31 komunat, duke përdorur platformat digjitale dhe mbledhje të vogël sipas lejeve nga Institucioni Shëndetësor Kombëtar i Kosovës, gjatë vitit 2020, këto komuna kanë organizuar 169 dëgjime publike, në të cilat morën pjesë 7,718 qytetarë. Dëgjimet publike të organizuara përmes platformave digjitale nxitën një pjesëmarrje më të lartë të publikut. Angazhimi më efektiv publik u tregua të jetë përmes mediave sociale, ku shtrirja ishte më e lartë. Komunat në vijim kanë pasur numrin më të lartë të dëgjimeve publike në vitin 2020:

#	Komuna	Numri i dëgjimeve publike (minimum 2 në vit)	Numri i pjesëmarrësve
1	Lipjan	22	500
2	Rahovec	15	155
3	Drenas	14	342
4	Shtime	13	470
5	Viti	13	225



|||||

# Vizitat e qytetarëve në faqet e internetit të komunës

Për t'iu përgjigjur pyetjes pse komunat duhet t'i publikojnë dokumentet publike në faqet e tyre të internetit, edhe atëherë kur ka platforma qendrore, KDI i ka marrë informatat që kanë të bëjnë me vizitat në faqet e internetit të komunave.

Sipas informatave të marra nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), faqet e internetit të komunave në vitin 2020 u vizituan **4,167,112** herë. Tabela më poshtë ilustron numrin e vizitorëve dhe vizitave në faqen e internetit kundrejt numrit të popullsisë<sup>23</sup>.

#	Komuna	# i vizitorëve në faqen e internetit	# i vizitave në faqen e internetit	# i popullsisë sipas Regjistrimit të vitit 2011	vizitorë kundrejt popullsisë në %	vizitat kundrejt popullsisë në %
1	Deçan	26,164	49,866	40,019	65%	125%
2	Dragash	24,954	62,777	33,997	73%	185%
3	Glllogoc	55,358	378,241	58,531	95%	646%
4	Ferizaj	35,884	78,286	108,610	33%	72%
5	Fushë Kosovë	37,755	105,876	34,827	108%	304%
6	Gjakovë	42,366	159,679	94,556	45%	169%
7	Gjilan	45,658	173,604	90,178	51%	193%
8	Graçanicë	16,026	30,130	10,675	150%	282%
9	Han i Elezit	14,051	25,308	9,403	149%	269%
10	Istog	31,102	78,589	39,289	79%	200%
11	Junik	8,314	17,551	6,084	137%	288%
12	Kaçanik	25,378	57,980	33,409	76%	174%
13	Kamenicë	34,324	96,798	36,085	95%	268%
14	Klinë	33,475	83,375	38,496	87%	217%

23 Regjistrimi i vitit 2011, ASK: <http://ask.rks-gov.net/media/2009/kosovo-census-atlas-2011.pdf>

|||||

INDEKSI I TRANSPARENCËS PËR QEVERISJEN KOMUNALE 2020

|||||

15	Klllokot	6,076	15,147	2,556	238%	593%
16	Leposaviq	2,609	10,460	13,773	19%	76%
17	Lipjan	50,551	215,901	57,605	88%	375%
18	Malishevë	33,737	76,956	54,613	62%	141%
19	Mamushë	7,486	20,273	5,507	136%	368%
20	Mitrovicë e Jugut	39,426	100,726	84,235	47%	120%
21	Mitrovicë e Veriut	3,038	10,860	29,460	10%	37%
22	Novobërdë	13,244	28,322	6,729	197%	421%
23	Obiliq	29,768	68,387	21,549	138%	317%
24	Partesh	7,859	13,224	1,787	440%	740%
25	Pejë	37,679	85,047	96,450	39%	88%
26	Podujevë	39,735	118,037	88,499	45%	133%
27	Prishtinë	270,293	1,310,692	198,897	136%	659%
28	Prizren	51,940	228,739	177,781	29%	129%
29	Rahovec	35,951	79,163	56,208	64%	141%
30	Ranillug	7,685	12,985	3,866	199%	336%
31	Shtërpcë	10,185	15,950	6,949	147%	230%
32	Shtime	26,316	46,558	27,324	96%	170%
33	Skenderaj	33,800	67,888	50,858	66%	133%
34	Suharekë	35,209	78,661	59,722	59%	132%
35	Viti	31,973	61,537	46,987	68%	131%
36	Vushtrri	38,693	96,392	69,870	55%	138%
37	Zubin Potok	2,282	3,461	6,616	34%	52%
38	Zvecan	2,506	3,686	7,481	33%	49%
<b>TOTAL</b>		<b>1,248,850</b>	<b>4,167,112</b>	<b>1,809,481</b>	<b>69%</b>	<b>230%</b>

|||||

# Komunikimi me komunën

Për të matur lehtësinë e qasjes në komunikim me komunat, KDI gjithashtu verifikoi mjetet për të komunikuar me komunat duke përdorur mjete në internet. 34 nga 38 komuna kanë kuti kontakti dhe/ose mekanizma të tjerë në internet ku qytetarët mund të paraqesin kërkesat e tyre dhe ato do të dorëzohen në tryezën e informacionit të komunës. Më poshtë është lista e komunave që kanë mekanizma të komunikimit në internet në faqet e tyre të internetit:

- |                 |               |              |
|-----------------|---------------|--------------|
| 1 Deçan         | 13 Kamenicë   | 25 Prishtinë |
| 2 Dragash       | 14 Klinë      | 26 Prizren   |
| 3 Drenas        | 15 Lipjan     | 27 Rahovec   |
| 4 Ferizaj       | 16 Malishevë  | 28 Ranilug   |
| 5 Fushë Kosovë  | 17 Mamushë    | 29 Shtërpcë  |
| 6 Gjakovë       | 18 Mitrovicë  | 30 Shtime    |
| 7 Gjilan        | 19 Novo Bërdë | 31 Skënderaj |
| 8 Graçanicë     | 21 Obiliq     | 32 Suharekë  |
| 9 Hani i Elezit | 22 Partesh    | 33 Viti      |
| 10 Istog        | 23 Pejë       | 34 Vushtrri  |
| 11 Junik        | 24 Podujevë   | 35 Zveçan    |
| 12 Kaçanik      |               |              |

# Informacion mbi ndërmarrjet komunale dhe institucionet vartëse

Një nga fushat më pak transparente të punës komunale, dhe fusha që shpesh akuzohet për korrupsion nga qytetarët dhe shoqëria civile, janë ndërmarrjet publike. Qytetarët përdorin rregullisht shërbimet e ofruara nga ndërmarrjet publike komunale, veçanërisht shërbimet komunale. Përderisa ka disa komuna që nuk kanë ndërmarrje publike, ka ndërmarrje publike rajonale që ofrojnë shërbime, dhe është e rëndësishme për komunat që të sigurojnë informata për qytetarët e tyre mbi legjislacionin e tyre rregullator, funksionet e tyre dhe të kush raportojnë këto ndërmarrje publike në nivel komunal. Me qëllim të verifikimit se sa informacion u ofrojnë komunat qytetarëve të tyre lidhur me ndërmarrjet publike, KDI ka matur dy treguesit në vijim.

1. A është skema organizative, përfshirë ndërmarrjet publike dhe institucionet vartëse, e publikuar në faqen e internetit?

Në vitin 2020, 31 komuna publikuan skemën organizative duke përfshirë ndërmarrjet publike dhe institucionet vartëse të publikuara në faqen e internetit. Ky është një ndryshim prej +14.8% në transparencën komunale në krahasim me vitin 2019 kur vetëm 27 komuna i publikuan ato.

# SHTYLLA V:

## Grantet dhe financimi

Grantet dhe financimi janë aktivitete shtesë përmes të cilave komunat shpenzojnë buxhetin e komunës.

Për të matur transparencën në grante dhe financime, KDI përdori treguesit e mëposhtëm:


1. A janë publikuar rregulloret për dhënien e granteve në faqen e internetit?
2. A janë publikuar thirrjet për aplikime për grante në faqen e internetit?
3. A janë publikuar rezultatet e shpërblimeve në faqen e internetit?
4. A ka informacion në lidhje me procesin e vlerësimit të projekteve?

Pikët maksimale të caktuara në këtë shtyllë janë 10 ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela djathtas tregon renditjen e komunave në këtë shtyllë. Niveli mesatar i transparencës në grante dhe financime është 58%.

87% e komunave publikuan thirrjet e tyre për aplikime për grante, dhe 72% publikuan rezultatet e dhënies së tyre, 70% e komunave publikuan rregulloret për dhëniet e granteve. Për fat të keq, viti 2020 shënoi një rënie të madhe në publikimin e procesit të vlerësimit për dhëniet e granteve nga 21% në vitin 2019 në vetëm 4% në vitin 2020. (12 komuna) kanë rregullore specifike për grante.

#	Komuna	Pikët
1	Prishtinë	10.00
2	Lipjan	8.75
3	Dragash	7.50
3	Drenas	7.50
3	Ferizaj	7.50
3	Gjakovë	7.50
3	Gjilan	7.50
3	Han i Elezit	7.50
3	Junik	7.50
3	Kaçanik	7.50
3	Kamenicë	7.50
3	Malishevë	7.50
3	Mamushë	7.50
3	Mitrovicë	7.50
3	Obiliq	7.50
3	Prizren	7.50
3	Skenderaj	7.50
3	Suharekë	7.50
3	Vushtrri	7.50
20	Graçanicë	6.25
20	Kllokot	6.25
20	Pejë	6.25
20	Podujevë	6.25
20	Rahovec	6.25
20	Shtime	6.25
20	Viti	6.25
27	Deçan	5.00
27	Klinë	5.00
27	Partesh	5.00
29	Fushë Kosovë	3.75
29	Istog	3.75
29	Novobërdë	3.75
29	Ranillug	3.75
34	Shtërpçë	1.25
35	Leposaviq	0.00
35	Mitrovicë e Veriut	0.00
35	Zubin Potok	0.00
35	Zvecan	0.00

Grafiku i mëposhtëm tregon performancën nga secili tregues në këtë shtyllë:



Në vitin 2020, 70% e komunave publikuan rregullore për dhënie e granteve. 20 komunat e mëposhtme publikuan këto rregullore:

- |                |              |              |
|----------------|--------------|--------------|
| 1 Deçan        | 8 Junik      | 15 Obiliq    |
| 2 Dragash      | 9 Kaçanik    | 16 Pristinë  |
| 3 Drenas       | 10 Kamenicë  | 17 Prizren   |
| 4 Ferizaj      | 11 Lipjan    | 18 Skënderaj |
| 5 Gjakovë      | 12 Malishevë | 19 Suharekë  |
| 6 Gjilan       | 13 Mamushë   | 20 Vushtrri  |
| 7 Han i Elezit | 14 Mitrovicë |              |





Ndërsa 13 komunat e mëposhtme përfshinin rregulloret në thirrjet e tyre për aplikime:

- |                |            |             |
|----------------|------------|-------------|
| 1 Fushë Kosovë | 6 Partesh  | 10 Ranilug  |
| 2 Graçanicë    | 7 Pejë     | 11 Shtërpcë |
| 3 Istog        | 8 Podujevë | 12 Shtime   |
| 4 Kllokot      | 9 Rahovec  | 13 Viti     |
| 5 Novo Bërdë   |            |             |

Më poshtë është lista e 33 (82%) komunave që publikuan thirrje për grante në faqet e tyre të internetit:

- |                |               |              |
|----------------|---------------|--------------|
| 1 Deçan        | 12 Kaçanik    | 23 Pejë      |
| 2 Dragash      | 13 Kamenicë   | 24 Podujevë  |
| 3 Drenas       | 14 Klinë      | 25 Pristinë  |
| 4 Ferizaj      | 15 Kllokot    | 26 Prizren   |
| 5 Fushë Kosovë | 16 Lipjan     | 27 Rahovec   |
| 6 Gjakovë      | 17 Malishevë  | 28 Ranillug  |
| 7 Gjilan       | 18 Mamushë    | 29 Shtime    |
| 8 Graçanicë    | 19 Mitrovicë  | 30 Skënderaj |
| 9 Han i Elezit | 20 Novo Bërdë | 31 Suharekë  |
| 10 Istog       | 21 Obiliq     | 32 Viti      |
| 11 Junik       | 22 Partesh    | 33 Vushtrri  |



28 komnat e mëposhtme (72%) publikuan rezultatet e dhënies së granteve në faqen e internetit.

- |             |              |              |
|-------------|--------------|--------------|
| 1 Junik     | 8 Mamushë    | 15 Prizren   |
| 2 Kaçanik   | 9 Mitrovicë  | 16 Rahovec   |
| 3 Kamenicë  | 10 Obiliq    | 17 Shtime    |
| 4 Klinë     | 11 Partesh   | 18 Skënderaj |
| 5 Klllokot  | 12 Pejë      | 19 Suharekë  |
| 6 Lipjan    | 13 Podujevë  | 20 Viti      |
| 7 Malishevë | 14 Prishtinë | 21 Vushtrri  |

Nga 38 komuna, vetëm Komuna e Prishtinës publikoi raportet e tyre të vlerësimit të granteve, ndërsa Lipjani publikoi raportet pa tabelat krahasuese.

# SHTYLLA VI:

## Etika profesionale dhe konflikti i interesit

Integriteti është një nga elementët kryesorë në menaxhimin e financave publike. Sa i përket matjes së mekanizmave për të mbështetur integritetin dhe luftën kundër korrupsionit, keqmenaxhimin, konfliktin e interesit dhe abuzimin e pushtetit zyrtar, KDI përdori treguesit e mëposhtëm për të matur mekanizmat e qeverisjes së mirë në komuna:

1. A ka komuna një kod etik?
2. A është publikuar Plani i Integritetit në faqen e internetit?
3. A ka ndonjë instrument për raportimin e sjelljeve joetike, diskriminimit ose konfliktit të interesit dhe a e ka caktuar zyrtarin përgjegjës në përputhje me ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve?
4. A janë publikuar lidhjet politike ose anëtarësimet në partitë politike për anëtarët e kuvendit në faqen e internetit të komunës?

Pikët maksimale të caktuara në këtë shtyllë janë tetë, ndërsa rezultati minimal është zero. Tabela djathtas tregon renditjen e komunave në këtë shtyllë.

Niveli mesatar i transparencës në etikën profesionale dhe konfliktin e interesit është 76%. Të gjitha komunat duhet t'i përmbahen Kodit të Etikës për administratën publike.

95% e komunave kanë konfirmuar se kanë krijuar struktura dhe instrumente për raportimin e sjelljeve joetike dhe kanë caktuar zyrtarin përgjegjës siç kërkohet nga Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve<sup>24</sup>, ndërsa pesë komuna nuk kanë konfirmuar nëse kanë plotësuar detyrimet e tyre sipas ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve.


#	Komuna	Pikët
1	Glllogoc	10.00
1	Gjakovë	10.00
1	Han i Elezit	10.00
1	Junik	10.00
1	Lipjan	10.00
1	Pejë	10.00
1	Prishtinë	10.00
1	Vushtrri	10.00
1	Ferizaj	10.00
10	Deçan	8.75
10	Kaçanik	8.75
10	Malishevë	8.75
10	Mamushë	8.75
10	Shtime	8.75
10	Skenderaj	8.75
10	Viti	8.75
17	Gjilan	7.50
17	Istog	7.50
17	Klinë	7.50
17	Podujevë	7.50
17	Prizren	7.50
17	Rahovec	7.50
23	Dragash	6.25
23	Fushë Kosovë	6.25
23	Graçanicë	6.25
23	Kamenicë	6.25
23	Mitrovicë	6.25
23	Novobërdë	6.25
23	Obiliq	6.25
23	Suharekë	6.25
31	Ranillug	5.00
31	Shtërpcë	5.00
31	Zveçan	5.00
34	Klllokot	3.75
34	Partesh	3.75
34	Zubin Potok	3.75
35	Leposaviq	1.25
35	Mitrovicë e Veriut	1.25

<sup>24</sup> [LIGJI Nr. 06/L –085 PËR MBROJTJEN E SINJALIZUESVE](#)

Indeksi ka treguar që 95% e komunave kanë publikuar përkatësinë politike të anëtarëve të kuvendit të tyre. 44% e komunave e kanë kodin e tyre të etikës, ndërsa vetëm 43% e komunave publikuan planet e tyre të integritetit.

Grafikët e mëposhtëm tregojnë renditjen e komunave sipas pikëve të fituara në secilën nga shtyllat dhe treguesit e lartpërmendur:

**TRANSPARENCA NË ETIKËN PROFESIONALE DHE KONFLIKTI I INTERESIT (%) 2018 - 2020**





Përderisa të 38 komunat operojnë nën kodin e etikës për administratën publike, 17 komuna kanë hartuar dhe miratuar kodin etik komunal të tyre. Më poshtë është lista e këtyre komunave: :

- |                |             |              |
|----------------|-------------|--------------|
| 1 Deçan        | 7 Istog     | 13 Prishtinë |
| 2 Drenas       | 8 Junik     | 14 Prizren   |
| 3 Ferizaj      | 9 Klinë     | 15 Rahovec   |
| 4 Gjakovë      | 10 Lipjan   | 16 Shtime    |
| 5 Gjilan       | 11 Pejë     | 17 Vushtrri  |
| 6 Han i Elezit | 12 Podujevë |              |

Në vitin 2020, 16 (43%) nga 38 komuna publikuan planet e tyre të vlefshme të integritetit në faqet e tyre të internetit. Më poshtë është lista e komunave që publikuan planet e tyre të integritetit. Komuna e Deçanit ka publikuar draft planin e integritetit për vitet 2020 - 2022, megjithatë, për shkak të pandemisë, plani nuk u aprovua gjatë periudhës së kësaj matjeje.

- |                |              |              |
|----------------|--------------|--------------|
| 1 Drenas       | 7 Lipjan     | 12 Rahovec   |
| 2 Ferizaj      | 8 Malishevë  | 13 Shtime    |
| 3 Gjakovë      | 9 Mamushë    | 14 Skënderaj |
| 4 Han i Elezit | 10 Pejë      | 15 Viti      |
| 5 Junik        | 11 Prishtinë | 16 Vushtrri  |
| 6 Kaçanik      |              |              |





Për më tepër, 36 (95%) nga 38 komuna raportuan se kanë instrument për raportimin e sjelljeve joetike, diskriminimit ose konfliktit të interesit dhe kanë caktuar zyrtarin përgjegjës në përputhje me ligjin për mbrojtjen e sinjalizuesve. Më poshtë është një listë e komunave që kanë instrumente për raportimin e sjelljeve joetike, diskriminimit ose konfliktit të interesit, përfshirë mekanizmat për zbatimin e kërkesave ligjore për mbrojtjen e sinjalizimit:

- |                |               |                |
|----------------|---------------|----------------|
| 1 Deçan        | 13 Kamenicë   | 25 Prishtinë   |
| 2 Dragash      | 14 Klinë      | 26 Prizren     |
| 3 Drenas       | 15 Kllokot    | 27 Rahovec     |
| 4 Ferizaj      | 16 Lipjan     | 28 Ranilug     |
| 5 Fushë Kosovë | 17 Malishevë  | 29 Shtërpçë    |
| 6 Gjakovë      | 18 Mamushë    | 30 Shtime      |
| 7 Gjilan       | 19 Mitrovicë  | 31 Skënderaj   |
| 8 Graçanicë    | 20 Novo Bërdë | 32 Suharekë    |
| 9 Han i Elezit | 21 Obiliq     | 33 Viti        |
| 10 Istog       | 22 Partesh    | 34 Vushtrri    |
| 11 Junik       | 23 Pejë       | 35 Zubin Potok |
| 12 Kaçanik     | 24 Podujevë   | 36 Zveçan      |





Në vitin 2020, 83% e komunave (33 nga 38) kanë publikuar në faqet e tyre të internetit përkatësitë politike ose anëtarësimet në parti politike për anëtarët e kuvendit. Më poshtë është një listë e komunave që kanë publikuar në faqet e tyre të internetit përkatësitë politike ose anëtarësimet në parti politike për anëtarët e kuvendit:

- |                 |               |              |
|-----------------|---------------|--------------|
| 1 Deçan         | 12 Kaçanik    | 23 Prishtinë |
| 2 Dragash       | 13 Kamenicë   | 24 Prizren   |
| 3 Drenas        | 14 Klinë      | 25 Rahovec   |
| 4 Ferizaj       | 15 Lipjan     | 26 Ranilug   |
| 5 Fushë Kosovë  | 16 Malishevë  | 27 Shtërpcë  |
| 6 Gjakovë       | 17 Mamushë    | 28 Shtime    |
| 7 Gjilan        | 18 Mitrovicë  | 29 Skënderaj |
| 8 Graçanicë     | 19 Novo Bërdë | 30 Suhareka  |
| 9 Hani i Elezit | 20 Obiliq     | 31 Viti      |
| 10 Istog        | 21 Pejë       | 32 Vushtrri  |
| 11 Junik        | 22 Podujevë   | 33 Zveçan    |









# REKOMANDIMET

## **Shtylla 1 Prokurimi publik ((përfshirë ankandet publike) 57% nga 100%):**

- Komunat duhet të publikojnë planin e prokurimit, publikimin e raportit vjetor të prokurimit për vitin paraprak, njoftimet për tenderë, njoftimet për dhënien e kontratës dhe njoftimet për ankandet.
- Për më tepër, ne rekomandojmë që të gjitha komunat të publikojnë njoftimet e tyre të kontratave dhe njoftimet për dhënie të kontratave, kontratat e nënshkruara, vendimet e OSHP-së dhe kërkesat e shkallës së parë dhe vendimet për procesin e prokurimit.

## **Shtylla 2 Transparenca Buxhetore (61% nga 100%):**

- Ne rekomandojmë që të gjitha komunat të publikojnë buxhetin, ndryshimet në buxhet, planin e investimeve, raportet tremujore të shpenzimeve, raportin përmbledhës për buxhetin e komunës për vitin paraprak fiskal, kornizën buxhetore afatmesme, raportin e auditimit dhe raportin vjetor për subvencionet në faqen e internetit të komunës.

## **Shtylla 3 Qasja në dokumente publike (84% nga 100%):**

- Ne rekomandojmë që të gjitha komunat të informojnë publikun për ato që konsiderohen të dhëna dhe informacione të mbrojtura, me qëllim të zvogëlimit të numrit të refuzimeve të kërkesave për qasje në dokumente dhe informacione publike

## **Shtylla 4 Informimi dhe pjesëmarrja e publikut (83% nga 100%):**

- Gjithashtu, ne rekomandojmë që komunat të publikojnë projekt-buxhetin dhe projekt agjendat dhe vendimet për konsultim me publikun.

- Si një praktikë e qeverisjes së mirë, me qëllim për të rritur më tej transparencën dhe llogaridhënien e zyrtarëve të zgjedhur lokalisht, ne rekomandojmë fuqimisht që, megjithëse nuk janë pjesë e këtij vlerësimi për vitin 2020, komunat duhet të publikojnë gjithashtu raportet gjashtëmujore dhe vjetore të kryetarit, dhe planet vjetore komunale.

## **Shtylla 5 Grantet dhe financimi (58% nga 100%):**

3. Në këtë shtyllë, ne rekomandojmë që komunat të fillojnë me publikimin e informacionit të plotë në lidhje me dhënien e financave për grante dhe aktivitete të mbështetura nga komunat.

## **Shtylla 6 Etika profesionale dhe konflikti i intereseve (73% nga 100%):**

- Në këtë shtyllë, ne inkurajojmë komunat të ndjekin shembullin e komunave të tjera duke zhvilluar kodet etike komunale të tyre duke përfshirë instrumente adekuate dhe specifike për raportimin e sjelljeve joetike.
- Ne gjithashtu rekomandojmë që komunat të publikojnë planet e tyre të integritetit dhe përkatësinë politike të udhëheqjes së tyre dhe anëtarëve të kuvendeve komunale.

**Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duhet të zhvillojë Procedurat Standarde të Operimit për popullimin e faqeve të internetit të komunave, të cilat duhet të përfshijnë gjithashtu udhëzimet standarde për emërtimin e dosjeve.**



Katalogimi në botim – (CIP)  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”





ISBN 978-9951-745-26-0



9 789951 745260

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen financiare të:



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA